

United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization

Regional Centre fo v Information Syste ch Infe Regionalni center za knjižnične

IZUM

© IZUM, 2025

Përmbajtja	2
Udhëzime për përdorimin e aplikacionit COBISS Cat	5
1 Hyrje	6
1.1 Hyrja në COBISS Cat	6
2 Ndërfaqja për katalogim	7
2.1 Dritarja për kërkim	7
2.1.1 Përzgjedhja e bazës së të dhënave	9
2.1.2 Shehimi i pyeljes për kërkimi (kërkimi i specializuar + skanimi) 2.1.3 Pasovra e termave	10
2.1.4 Parashtesat dhe prapashtesat për kërkim	11
2.1.5 Përzgjedhja e fushës për kërkim (kërkimi i avancuar)	11
2.1.6 Perzgjedhja e operatoreve shtese 2.1.7 Shënimi i pveties për kërkim (kërkimi i avancuar)	11
2.1.8 Gjetja e regjistrimeve	12
2.1.9 Kërkimi i ri	12
2.1.10 Kërkimi i fundit 2.1.11 Shtimi i fushës për kërkim	12
2.1.12 Shndërrimi i pveties për kërkim	13
2.1.13 Largimi i fushës për kërkim	13
2.1.14 Lista e ID-ve	13
2.1.15 Klasifikimi i rezultateve te kerkimit 2.1.16 Ruaitia e ovetësorit	14
2.1.17 Redaktimi i pyetësorit	14
2.1.18 Transferimi në skedarin tekst	14
2.1.19 Përzgjedhja e formatit të listës së rezultateve të kërkimit	14
2.1.20 Formater e indes se rezultateve te kerkinnt 2.1.21 1000 të tiera	15
2.1.22 Rezultatet e kërkimit	15
2.1.23 Shtimi i regjistrimit në hapësirën e punës	16
2.1.24 Redaktimi i regjistrimit 2.1.25 Rediistrimi i ri	16 16
2.1.26 Shfaqja e regjistrimit në dritaren për kërkim	16
2.1.27 Shfaqja e regjistrimeve në COBISS+	17
2.1.28 Krahasimi i regjistrimeve në dritaren për kërkim	18
2.1.29 Verminin i dublikatave 2.1.30 Lidhia e regiistrimeve	18
2.1.31 Tipologjia	20
2.1.32 Bibliografitë	20
2.1.32.1 Pergaliga e biologrative 2.1.32.2 Qasja në skedarët e ruajtur me raportet	20 20
2.1.33 Formatet e përdoruesit për bibliografitë	21
2.1.33.1 Pergaluga formateve të përdoruesit 2.1.33.1.1 Shtimi dhe ndryshimi i formateve të përdoruesit	21
2.1.34 Eksportimi i regjistrimeve	22
2.1.35 Lidhja e regjistrimeve lokale	22
2.2 Hapësira e punës	23
2.2.1 Regjistrimi i ri 2.2.2 Esbiria e regijetrimit	24
2.2.3 Përfto një regjistrim të ri	25
2.2.4 Klasifikimi i regjistrimeve	26
2.2.5 Shfaqja e regjistrimit në hapësirën e punës	26
2.2.7 Përzojedhia e fushave për transferim në kuitesën e fragmenteve apo në redaktues	20 26
2.2.8 Verifikimi i dublikatave	27
2.2.9 Shfaqja në COBISS+	27
2.2.10 Shfaqja e listes se bibliotekave 2.2.11 Marria ose anulimi i përgjegjësisë për regjistrimin	27 28
2.2.12 Largimi i regjistrimeve	28
2.2.13 Redaktimi i regjistrimit	28
2.2.14 Shkarkimi i regjistrimeve nga Svaroga 2.2.15 Paragitia e regiistrimit	29 29
2.2.16 Shfaqja e hapësirës së punës	29
2.3 Redaktuesi i regjistrimit	29
2.3.1 Shënimi i të dhënave	32
2.3.2 Verifikimi i regjistrimit 2.3.3 Buaitia e regiistrimit	34
2.3.4 Ruajtia si model	35
2.3.5 Anulimi	35
2.3.6 Shtimi i fushës	35
2.3.7 Shumi i (nen)iusnes se perzgjeonur nga kujtesa e fragmenteve 2.3.8 Ndrvshimi i maskës për shënimin e të dhënave	36
2.3.9 Shfaqja/fshehja e butonit për zhvendosjen e fushës/nënfushës	36

	30
2.3.11 Vendosja e simbolit për klasifikim	37
2.3.12 Vendosja e simbolit La LeX	37
2.3.14 Shndërrimi i shkrimit	37
2.3.15 Numëratorët	37
2.3.15.1 Përcaktimi dhe redaktimi i numëratorit 2.3.15.2 Shënimi i të dhënave me ndihmën e numëratorit	37
2.3.16 Grupet për shënimin e të dhënave	39
2.3.17 Butonat me shenjat e fushave/nënfushave/treguesve	39
2.3.17.1 Shtimi i fushave/nënfushave	39 40
2.3.17.3 Ndryshimi i fushës/nënfushës	40
2.3.17.4 Fshirja e fushës/nënfushës 2.3.17.5 Shtimi i vlerës së paracaktuar në nënfushë	40 41
2.3.17.6 Ndryshimi i vetive të fushave/nënfushave	41
2.3.1/./ Ndryshimi i vierave te treguesve 2.3.18 Zhvendosia e fushës/nënfushës	44
2.3.19 Shtimi/fshirja e fushës/nënfushës	44
2.3.20 Manualët në formën elektronike	44
2.3.21 Parametrat e përdoruesit	45
2.3.22 Lidhja me COBISS Lib	45
2.4 Paraquesi i regiistrimit	40
3 Procedurat baze te punes me regjistrimet	48
4 Lista e shkurtoreve (tasteve të shpejta) për aplikimin e disa procedurave	49
5 Simbolet, drejtshkrimi dhe mundësitë e tjera	51
5.1 Vendosja e simboleve me ndihmën e tastierës	51
5.2 Tabelat e simboleve	51
5.3 Shtimi i gjuhës dhe ndryshimi i konfigurimit të tastierës	53
5.4 Shtimi i tastierës në ekran	54
5.5 Drejtshkrimori	57
5.6 Kontrollimi automatik i tekstit	58
5.7 Veprimet me skedarët	58
6 Indekset për kërkim	60
6.1 Bazat bibliografike të të dhënave	60
6.1.1 Indeksi bazë	60
6.1.1.1 Të dhënat bibliografike 6.1.1.2 Të dhënat për përmhaitien (emërtimet lëndore, klasifikimi)	60 60
6.1.2 Indekset shtesë	61
6.1.2.1 Të dhënat për regjistrimin 6.1.2.2 Të dhënat bibliografike	61
6.1.2.3 Të dhënat identifikuese	62
6.1.2.4 Të dhënat për përmbajtjen (emërtimet lëndore, klasifikimi) 6.1.2.5 Të dhënat e koduara	63 64
6.1.3 Kufizimi	67
6.2 Baza e njësuar e të dhënave CONOR	68
6.2.1 Indeksi bazë	68
6.2.2 INDEKSET SNTESE	68 68
6.2.2.1 Tế dhênat pêr realistrímin	68
6.2.2.1 Të dhënat për regjistrimin 6.2.2.2 Të dhënat e njësuara	
6.2.2.1 Të dhënat për regjistrimin 6.2.2.2 Të dhënat e njësuara 6.2.3 Të dhënat e koduara 6.2.3 Kufizimi	69
6.2.2.1 Të dhënat për regjistrimin 6.2.2.2 Të dhënat e njësuara 6.2.3 Të dhënat e koduara 6.2.3 Kufizimi 6.3 Baza e njësuar e të dhënave SGC	69 69
6.2.2.1 Të dhënat për regjistrimin 6.2.2.2 Të dhënat e njësuara 6.2.3 Të dhënat e koduara 6.2.3 Kufizimi 6.3 Baza e njësuar e të dhënave SGC 6.3.1 Indeksi bazë	69 69 69
6.2.2.1 Të dhënat për regijstrimin     6.2.2.2 Të dhënat e njësuara     6.2.2.3 Të dhënat e koduara     6.2.3 Kufizimi     6.3.3 Kufizimi     6.3 Baza e njësuar e të dhënave SGC     6.3.1 Indeksi bazë     6.3.2 Indekset shtesë     6.3.2 Indekset shtesë	69 69 69 69 70
6.2.2.1 Të dhënat për regjistrimin         6.2.2.2 Të dhënat e njësuara         6.2.2.3 Të dhënat e koduara         6.2.3 Kufizimi         6.3.3 Baza e njësuar e të dhënave SGC         6.3.1 Indeksi bazë         6.3.2 Indekset shtesë         6.3.2.1 Të dhënat për regjistrimin         6.3.2.2 Të dhënat e njësuara	69 69 69 69 70 71 71 71
6.2.2.1 Të dhënat për regjistrimin     6.2.2.2 Të dhënat e njësuara     6.2.2.3 Të dhënat e koduara     6.2.3 Kufizimi     6.3 Baza e njësuar e të dhënave SGC     6.3.1 Indeksi bazë     6.3.2 Indekset shtesë     6.3.2 Indekset shtesë     6.3.2.1 Të dhënat për regjistrimin     6.3.2.2 Të dhënat e njësuara     6.3.3 Të dhënat e njësuara     6.3.3 Të dhënat identifikuese     6.3.4 Të dhënat identifikuese     6.3.4 Të dhënat e njësuara	69 69 69 70 71 71 72 72
6.2.2.1 Të dhënat për regjistrimin         6.2.2.2 Të dhënat e njësuara         6.2.2.3 Të dhënat e koduara         6.2.3 Kufizimi         6.3.3 Baza e njësuar e të dhënave SGC         6.3.1 Indeksi bazë         6.3.2 Indekset shtesë         6.3.2.1 Të dhënat për regjistrimin         6.3.2.2 Të dhënat e njësuara         6.3.2.1 Të dhënat për regjistrimin         6.3.2.2 Të dhënat e njësuara         6.3.2.3 Të dhënat e koduara         6.3.2.4 Të dhënat e koduara         6.3.3 Kufizimi	69 69 69 70 71 71 72 72 72
6.2.2.1 Të dhënat për regjistrimin         6.2.2.2 Të dhënat e njësuara         6.2.2.3 Të dhënat e koduara         6.2.3 Kufizimi         6.3.3 Baza e njësuar e të dhënave SGC         6.3.1 Indeksi bazë         6.3.2 Indekset shtesë         6.3.2.1 Të dhënat e regjistrimin         6.3.2.2 Të dhënat e njësuara         6.3.2 Indekset shtesë         6.3.2.1 Të dhënat e njësuara         6.3.2.2 Të dhënat e njësuara         6.3.2.3 Të dhënat e njësuara         6.3.3 Kufizimi         6.4 CORES	69 69 69 70 71 71 72 72 72 73
6.2.2.1 Të dhënat për regjistrimin         6.2.2.2 Të dhënat e njësuara         6.2.2.3 Të dhënat e koduara         6.2.3 Të dhënat e koduara         6.2.3 Kufizimi         6.3.3 Baza e njësuar e të dhënave SGC         6.3.1 Indeksi bazë         6.3.2 Indekset shtesë         6.3.2 Indekset shtesë         6.3.2.3 Të dhënat e njësuara         6.3.2 Të dhënat e njësuara         6.3.2.3 Të dhënat e njësuara         6.3.2.4 Të dhënat e njësuara         6.3.3 Kufizimi         6.4 CORES         6.4.1 Indeksi bazë	69 69 69 70 71 71 72 72 72 73 73 73
<ul> <li>6.2.1 Të dhënat për regjistrimin</li> <li>6.2.2 Të dhënat e njësuara</li> <li>6.2.3 Të dhënat e koduara</li> <li>6.2.3 Kufizimi</li> <li>6.3 Baza e njësuar e të dhënave SGC</li> <li>6.3.1 Indeksi bazë</li> <li>6.3.2 Indekset shtesë</li> <li>6.3.2 Indekset shtesë</li> <li>6.3.2 Të dhënat e njësuara</li> <li>6.3.2 Të dhënat për regjistrimin</li> <li>6.3.2 Të dhënat e njësuara</li> <li>6.3.2 Të dhënat e njësuara</li> <li>6.3.3 Kufizimi</li> <li>6.4 CORES</li> <li>6.4.1 Indeksi bazë</li> <li>6.4.2 Indekset shtesë</li> <li>6.4.2 Indekset shtesë</li> </ul>	69 69 69 70 71 71 72 72 72 73 73 73
6.2.2.1 Të dhënat për regjistrimin         6.2.2.2 Të dhënat e njësuara         6.2.2.3 Të dhënat e koduara         6.2.3 Kufizimi         6.3.3 Baza e njësuar e të dhënave SGC         6.3.1 Indeksi bazë         6.3.2 Indekset shtesë         6.3.2.1 Të dhënat e njësuara         6.3.2.1 Të dhënat për regjistrimin         6.3.2.1 Të dhënat për regjistrimin         6.3.2.1 Të dhënat e njësuara         6.3.2.1 Të dhënat e njësuara         6.3.2.1 Të dhënat e koduara         6.3.2.1 Të dhënat e koduara         6.3.3.3 Kufizimi         6.4.2 Indekset shtesë         6.4.1 Indeksi bazë         6.4.2 Indekset shtesë         6.4.2 Indekset shtesë         6.5.1 ISSN         6.5.1 Indekset shtesë	69 69 69 70 71 72 72 72 73 73 73 73 73 73
6.2.2.1 Të dhënat për regjistrimin         6.2.2.3 Të dhënat e njësuara         6.2.3 Kufizimi         6.3.3 Kufizimi         6.3.1 Indeksi bazë         6.3.2.1 Të dhënat për regjistrimin         6.3.2.1 Të dhënat e njësuara         6.3.2.1 Të dhënat e njësuara         6.3.2.3 Të dhënat e njësuara         6.3.2.4 Të dhënat e koduara         6.3.3 Kufizimi         6.4 CORES         6.4.1 Indeksi bazë         6.4.2 Indekset shtesë         6.5 ISSN         6.5.1 Indekset shtesë	69 69 69 70 71 72 72 73 73 73 73 73 73 73 73
6.2.1 Të dhënat për regjistrimin         6.2.2 Të dhënat e njësuara         6.2.3 Të dhënat e koduara         6.2.3 Kufizimi         6.3 Baza e njësuar e të dhënave SGC         6.3.1 Indeksi bazë         6.3.2 Indekset shtesë         6.3.2.1 Të dhënat për regjistrimin         6.3.2.3 Të dhënat e njësuara         6.3.2.1 Të dhënat për regjistrimin         6.3.2.2 Të dhënat e njësuara         6.3.2.3 Të dhënat e koduara         6.3.2.4 Të dhënat e koduara         6.3.3 Kufizimi         6.4 CORES         6.4.1 Indeksi bazë         6.4.2 Indekset shtesë         6.5 ISSN         6.5.1 Indekset shtesë         7.1 Rezrat bibliografiko të të dhënave	69 69 69 70 71 71 72 72 72 73 73 73 73 73 73 74 74 74 75
6.2.2.1 Të dhënat për regjistrimin         6.2.2.2 Të dhënat e koduara         6.2.3 Kufizimi         6.3 Baza e njësuar e të dhënave SGC         6.3.1 Indeksi bazë         6.3.2 Indekset shtesë         6.3.2 Të dhënat për regjistrimin         6.3.2.3 Të dhënat për regjistrimin         6.3.2.1 Të dhënat për regjistrimin         6.3.2.1 Të dhënat për regjistrimin         6.3.2.3 Të dhënat e njësuara         6.3.2.3 Të dhënat e njësuara         6.3.2.3 Të dhënat e njësuara         6.3.2.3 Të dhënat e koduara         6.3.2.3 Të dhënat e koduara         6.3.3 Kufizimi         6.4 CORES         6.4.1 Indeksi bazë         6.4.2 Indekset shtesë         6.5.1 SSN         6.5.1 Indekset shtesë         7 Verifikimi i regjistrimeve në mënyrë automatike         7.1 Bazat bibliografike të të dhënave	69 69 69 70 71 71 72 72 73 73 73 73 73 74 74 74 75 75
6.2.2.1 Të dhënat për regjistrimin         6.2.2.2 Të dhënat e koduara         6.2.2.3 Të dhënat e koduara         6.2.3 Kufizimi         6.3 Baza e njësuar e të dhënave SGC         6.3.1 Indeksi bazë         6.3.2 Indekset shtesë         6.3.2 Të dhënat për regjistrimin         6.3.2 Të dhënat për regjistrimin         6.3.2 Të dhënat të redjistrimin         6.3.2 Të dhënat të regjistrimin         6.3.2 Të dhënat të njësuara         6.3.2 Të dhënat të njësuara         6.3.3 Kufizimi         6.4.2 Të dhënat e koduara         6.3.3 Kufizimi         6.4 CORES         6.4.1 Indekset shtesë         6.5 ISSN         6.5.1 SSN         6.5.1 Indekset shtesë         7 Verifikimi i regjistrimeve në mënyrë automatike         7.1 Bazat bibliografike të të dhënave         7.2 Bazat e njësuara të të dhënave         7.3 CORES	69 69 69 70 71 71 72 72 72 73 73 73 73 73 73 74 74 75 75 86
6.2.1 Të dhënat për regjistrimin 6.2.2 Të dhënat e rijësuara 6.2.3 Kufizimi 6.3 Baza e njësuar e të dhënave SGC 6.3.1 Indeksi bazë 6.3.2 Indekset shtesë 6.3.2 Indekset shtesë 6.3.2 Itë dhënat e njësuara 6.3.2 Të dhënat e njësuara 6.3.2 Të dhënat e njësuara 6.3.3 Kufizimi 6.4 CORES 6.4.1 Indeksi bazë 6.4.1 Indeksi bazë 6.4.2 Indekset shtesë 7 Verifikimi i regjistrimeve në mënyrë automatike 7.1 Bazat bibliografike të të dhënave 7.2 Bazat e njësuara të të dhënave 7.3 CORES 8 METADAT	69 69 69 70 71 72 72 73 73 73 73 73 73 73 73 73 73 73 73 73
6.2.1 Të dhënat për egjistrimin         6.2.2 Të dhënat e njësuara         6.2.3 Kufizimi         6.3 Baza e njësuar e të dhënave SGC         6.3.1 Indeksi bazë         6.3.2 Indekset shtesë         6.3.2 I të dhënat e njësuara         6.3.2 Të dhënat e njësuara         6.3.2 Të dhënat e njësuara         6.3.2 Të dhënat e njësuara         6.3.3 Sufizimi         6.4 CORES         6.4.1 Indeksi bazë         6.4.2 Indekset shtesë         6.5 I IsSN         6.5.1 Indekset shtesë         7 Verifikimi i regjistrimeve në mënyrë automatike         7.1 Bazat bibliografike të të dhënave         7.2 Bazat e njësuara të të dhënave         7.3 CORES         8 METADAT         9.4 Ditaria në të të dhënave	69 69 69 70 71 72 72 73 73 73 73 73 73 73 74 74 75 86 91 93
6.2.2.1 Të dhënat për regjistrimin         6.2.2.2 Të dhënat e rijësuara         6.2.3 Kufizimi         6.3.3 Baza e njësuar e të dhënave SGC         6.3.1 Indeksi bazë         6.3.2 Indekset shtesë         6.3.2 Të dhënat e regjistrimin         6.3.2 Të dhënat e regjistrimin         6.3.2 Të dhënat e regjistrimin         6.3.2 Të dhënat e për regjistrimin         6.3.2 Të dhënat e rogjistrimin         6.3.2 Të dhënat e koduara         6.3.3 Kufizimi         6.3.4 Të dhënat e koduara         6.3.3 Kufizimi         6.4 CORES         6.4.1 Indeksi bazë         6.4.2 Indekset shtesë         7 Verifikimi i regjistrimeve në mënyrë automatike         7.1 Bazat bibliografike të të dhënave         7.2 Bazat e njësuara të të dhënave         7.2 Bazat e njësuara të të dhënave         7.3 CORES         8 METADAT         8.1 Dritarja për kërkim	69 69 69 70 71 71 72 72 73 73 73 73 73 73 73 73 73 73 73 73 73
6.2.2.1 Të dhënat e rijësuara         6.2.2.2 Të dhënat e rijësuara         6.2.3 Kufizimi         6.3.3 Baza e njësuar e të dhënave SGC         6.3.1 Indeksi bazë         6.3.2 Indekset shtesë         6.3.2 Të dhënat e registrimin         6.3.2 Të dhënat e registrimin         6.3.2 Të dhënat e përsuara         6.3.2 Të dhënat e përsuara         6.3.2 Të dhënat e rogistrimin         6.3.2 Të dhënat e rogistrimin         6.3.2 Të dhënat e koduara         6.3.3 Kufizimi         6.4.2 Të dhënat e koduara         6.3.3 Kufizimi         6.4 CORES         6.4.1 Indeksi bazë         6.4.2 Indekset shtesë         7 Verifikimi i regjistrimeve në mënyrë automatike         7.1 Bazat bibliografike të të dhënave         7.2 Bazat e njësuara të të dhënave         7.3 CORES         8 METADAT         8.1 Dritarja për kërkim         8.2 Hapësira e punës         8.3 Podaturcei i rogiistrimit	69 69 69 70 71 71 72 72 73 73 73 73 73 73 73 73 73 73 73 73 73
6.2.2.1 Të dhënat për regjistrimin         6.2.2.3 Të dhënat e njësuara         6.2.3 Kufizimi         6.3.3 Baza e njësuar e të dhënave SGC         6.3.1 Indeksi bazë         6.3.2 Indekset shtesë         6.3.2 Të dhënat e njësuara         6.3.3 Indekset shtesë         6.3.4 Kufizimi         6.3.2 Të dhënat për regjistrimin         6.3.2 A Të dhënat koduara         6.3.3 Kufizimi         6.4 CORES         6.4.1 Indeksi bazë         6.4.2 Indekset shtesë         6.5 ISSN         6.5.1 Indekset shtesë         7 Verifikimi i regjistrimeve në mënyrë automatike         7.1 Bazat bibliografike të të dhënave         7.3 CORES         8 METADAT         8.1 Dritarja për kërkim         8.2 Hapësira e punës         8.3 Redaktuesi i regjistrimit         8.4 Paragitkëti	69 69 69 70 71 72 72 72 73 73 73 73 73 73 73 73 73 73 73 73 73
6.2.2.1 ře diheat pregistrimi         6.2.2.3 Té diheat v kodura         6.2.3 Kufizimi         6.3.3 Baza e njësuar e të dhënave SGC         6.3.1 Indeksi bazë         6.3.2 Indekset shtesë         6.3.3 Kufizimi         6.4 CORES         6.4.1 Indeksi bazë         6.4.2 Indekset shtesë         6.5 ISSN         6.5.1 Indekset shtesë         7 Verifikimi i regjistrimeve në mënyrë automatike         7.1 Bazat bibliografike të të dhënave         7.2 Bazat e njësuara të të dhënave         7.3 CORES         8 METADAT         8.1 Dritarja për kërkim         8.2 Hapësira e punës         8.3 Redaktuesi i regjistrimit         8.4 Paraqitësi         9 K ësebilla për përdorimin o COBISE Cot	69 69 69 70 71 72 72 73 73 73 73 73 73 73 73 73 73 73 73 73

COBISS Cat

# Udhëzime për përdorimin e aplikacionit COBISS Cat

# 1 Hyrje

Gjenerata e re e programit, COBISS Cat, është aplikacion në internet. Për shkak se funksionon në një shfletues interneti mund të përdoret edhe në pajisje mobile. Krahas COBISS Cat mund të përdorni edhe programin COBISS3/Katalogimi

Aplikacioni COBISS Cat do të ketë funksione të njëjta me COBISS3/Katalogimin, mirëpo funksionet e implementuara në fazën fillestare janë të kufizuara. Për këtë arsye përkohësisht është i mundur përdorimi edhe i COBISS3/Katalogimi edhe i COBISS Cat.

## 1.1 Hyrja në COBISS Cat

Në aplikacion hyni përmes adresës https://cat.cobiss.net/cat/. Në dritaren për lidhje COBISS Cat duhet të shënoni akronimin e bibliotekës, emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin që keni në COBISS Cat.

Në COBISS Cat përdoruesit kanë të njëjtat autorizime, të cilat i kanë pasur në COBISS3/Katalogimi.

	Katalogimi	
	1.3 13.10.2023 12:48	
Akronimi i bib	liotekës	
#		
Emri i përdoru	esit	
4		
Fjalëkalimi		
<b></b>		
Gjuha		
Albanian		`
Më mbaj	mend	

### Dritarja për lidhje COBISS Cat

Pas lidhjes, në skedën e shfletuesit të internetit, përkrah fjalës Katalogimi shfaqet edhe akronimi i bibliotekës.



# 2 Ndërfaqja për katalogim

Në ndërfaqen për katalogim zhvillohen procedurat e përpunimit të burimeve bibliografike dhe procedurat e punës me regjistrimet e njësuara.

Elementet e ndërfaqes:

- 1. Butoni që shfaq apo fsheh hapësirën e punës
- 2. Butoni për qasje në manualët në formë elektronike
- 3. Butoni për parametrat e përdoruesit
- 4. Butoni për kalim direkt në COBISS Lib
- 5. Butoni me informacionin për bazën dhe përdoruesin, i cili shërben edhe për t'u shkëputur nga programi
- 6. Butoni për shfaqjen e dritares për kërkim ose të redaktuesit të regjistrimit
- 7. Hapësira e punës
- 8. Redaktuesi i regjistrimit
- 9. Paraqitësi i regjistrimit



Ndërfaqja për katalogim

Nëpër elementet e ndërfaqes mund të lëvizni përmes miut ose tastit <Tab>, ndërsa nëpër lista (p.sh. listat e regjistrimeve, termave për kërkim, pikëqasjeve) përmes miut ose tasteve për lëvizje <lart>, <poshtë>, <PgUp>, <PgDn>. Përzgjedhjen e konfirmoni me tastin për hapësirë, tastin <Enter> ose duke klikuar në kutinë e zgjedhjes

## 2.1 Dritarja për kërkim

Me ndihmën e pyetjeve në dritaren për kërkim mund të gjeni regjistrimet në bazat bibliografike dhe në bazat e njësuara. Dritarja për kërkim për bëhet nga dy pjesë. Pjesa e sipërme përdoret për shënimin e pyetjeve për kërkim, ndërsa pjesa e poshtme për shfaqjen e rezultateve të kërkimit.

Dritarja për kërkim aktivizohet duke klikuar në butonin **Q**, *i* cili ndodhet në hapësirën e punës.

+ COBISS Cet							? 0	tí 4	BASH: sys_simonat Θ
Q /			0	OBIB	0	✓ la=alb and 105f=g	2	ж ө	۹.
o		×						9 6	
COBISS.SI 12584020	1	×	A	utor -	person	- leka'	· • 0	××	9 0
Hall sensor, sensor assemi	bly incl	luding I	Т	itulli	6			××	+ =>
OBIB 1537955056 History of Albania : from i	ts origi	× ns to th		tel I bre		1001			U Q
ASH 1537955056	1	×	V	IU I DO	otimit -	199-	F	<u> </u>	3 Lista e ID-ve
History of Albania : from i	ts origi	ns to th	Kla	sifikim	COBISS.AL-	ID You IL	Pyetësorët e mi:	•	
SASH -1	-	×							0
The jurisprudence of med	icine.	×	6	2	Formati i paracak	tua 🛩 👌 🔹 1000 të tjer	Numri i gjetjeve: 12		
CONOR 412774 Kadare, Ismail	1	×	_	Ð		20 21 (	22 23		
SSN 623580 Dialektologija shqiptare	1	×		Nr.	COBISS.AL-ID 0	Pikēqasja e pērshkrimit kryesor o	Titulli dhe të dhënat për përgjegjësinë o	Viti i botimit	o Botuesi o
COBIB 6928903	1	×		1	23883274	Ahmeti, Linditë	Ishulli adular / Linditë Ahmeti : [ballina Lulzime Leka]	1996	Shkupi
Ftesë në studio				2	52141063	Leka. Ganimete	Lutje yjeve / Ganimete Leka	1992	Shkëndija
				3	512334553	Fishta, Gjergj, At	Mrizi i zanave / Gjergj Fishta : [përgatitën për shtyp Arian Leka, Nasi Lera]	1999	"Naim Frashëri"
				4	1536102640	Borges. Jorge Luis	Poezia / Jorge Luis Borgues : pērkthyen Arian Leka, Arnisa Zeqo	1997	Dea
				5	1537032176	Leka Stefa, Vitore	La libertá : poezi që merr frymë pas pushkatimit / Vitore Leka	1993	Jani Vruho
				6	1537189616	Petrarca, Francesco	Lirika të zgjedhura nga Canzoniere = Rime scelte dal Canzoniere / Françesko Petrarka :	1998	Dituria
				7	1537762032	Leka, Dhora	Këngë në shtrëngatë : poezi / Dhora Leka	1998	Dritëro
				8	1555286496	Reshma, Osman	Koha e çudirave : poezi / Osman A. Reshma : redaktoi: Hasan Lekaj	1999	Shtëpia Botues
				9	1556033760	Leka, Ganimete, 1977-	Në kufirin e shpresës = : An der Grenze der Hoffnung / Ganimete Leka, Jakob Paul Gillm	1995	Shoqata e shkri
				10	2048203312	Leka. Suada	Nēse Qielli : poezi / Suada Leka : pērgatīti botimin Alfred Ziu	1999	Medaur
			€.	1					•
			5	Shto	Redakto F	Regjistrimi i ri Shfaq Shfac	q në COBISS + 25 Krahaso Verifiko dublikatat Lidh Tipologjia Bibliografi	të Eksport	0

Dritarja për kërkim

Elementet e dritares për kërkim janë:

- 1. Lista për përzgjedhjen e bazës së të dhënave
- 2. Fusha për shënimin e pyetjeve për kërkim (kërkimi i specializuar + skanimi)
- 3. Butoni <sup>22</sup> për pasqyrën e termave
- 4. Butoni <sup>2</sup> për shfaqjen e listës së parashtesave dhe prapashtesave për kërkim
- 5. Lista për përzgjedhjen e fushës për kërkim (kërkimi i avancuar)
- 6. Lista për përzgjedhjen e operatorëve shtesë
- 7. Fusha për shënimin e pyetjes për kërkim (kërkimi i avancuar)
- 8. Butoni q gjej
- 9. Butoni 🧖 për ekzekutimin e kërkimit të ri
- 11. Butoni <sup>+</sup> për shtimin e fushave për kërkim (kërkimi i avancuar)
- 12. Butoni <sup>=></sup> për shndërrimin e pyetjes për kërkim nga kërkimi i avancuar në atë të specializuar
- 13. Butoni 🎽 për largimin e fushave për kërkim (kërkimi i avancuar)
- 14. Butoni Lista e ID-ve për shtimin e listës së numrave identifikues
- 15. Lista për përzgjedhjen e të dhënës, sipas të cilës do të klasifikohen rezultatet e kërkimit; mund të klasifikohen sipas rendit ngritës (butoni ) ose sipas rendit zbritës (butoni )

- 16. Lista për përzgjedhjen e pyetësorëve të ruajtur
- 17. Butoni 📕 për ruajtjen e pyetësorit
- 18. Butoni 🏾 për redaktimin e pyetësorëve të ruajtur
- 19. Butoni 🛄 për transferimin e rezultateve të kërkimit në skedarin tekst
- 20. Lista për përzgjedhjen e formatit për shfaqjen e rezultateve të kërkimit
- 21. Butoni 🏾 për shfaqjen e rezultateve të kërkimit
- 22. Butoni **1000 të tjera** për shfaqjen e 1000 regjistrimeve të tjera, ndërsa tek disa baza të huaja butoni **100 të tjera**
- 23. Numri i regjistrimeve, të cilat programi i ka gjetur në bazën e të dhënave dhe që i përshtaten pyetjes për kërkim
- 24. Lista e rezultateve të kërkimit
- 25. shiriti me butonat, të cilët shfaqen varësisht nga baza e përzgjedhur e të dhënave
  - Shto për transferimin e regjistrimeve në hapësirën e punës
  - Redakto për transferimin e regjistrimit të përzgjedhur në redaktues
  - Regjistrimi i ri për krijimin e regjistrimit
  - Shfaq për kontrollimin e regjistrimeve
  - Shfaq në COBISS+ për shfaqjen e regjistrimit në COBISS+
  - Krahaso për krahasimin e regjistrimeve
  - **Verifiko dublikatat** për të verifikuar në mënyrë automatike, nëse regjistrimi i përzgjedhur është dublikat i regjistrimeve që tashmë ndodhen në COBIB
  - Lidh për lidhjen në paketë të regjistrimeve bibliografike me regjistrimet e njësuara
  - **Tipologjia** për verifikimin e tipologjisë (në dispozicion vetëm për OSIC)
  - **Bibliografitë** për përgatitjen e bibliografive dhe listat e emërtimeve lëndore
  - Eksporto për eksportin e regjistrimeve në formate të ndryshme
  - **Lidh regjistrimet lokale** për procedurën e verifikimit dhe ruajtjes së regjistrimeve lokale (000e = only) në COBIB (ky buton është në dispozicion vetëm në disa biblioteka)

Për të mbyllur dritaren për kërkim apo për të hapur redaktuesin klikoni butonin *Q n*ë hapësirën e punës apo shtypni tastin <F8>.

#### 2.1.1 Përzgjedhja e bazës së të dhënave

Mund të përzgjidhni baza të ndryshme të të dhënave (vendore dhe të huaja):

- Baza lokale kërkimi i regjistrimeve bibliografike në bazën lokale
- COBIB kërkimi i regjistrimeve në bazën e përbashkët bibliografike
- COBISS.net kërkimi i regjistrimeve në bazat e përbashkëta bibliografike në rrjetin COBISS.net
- Katalogu LC kërkimi i regjistrimeve në katalogun e Bibliotekës së Kongresit
- WorldCat kërkimi i regjistrimeve në bazën bibliografike WorldCat

- CONOR kërkimi i regjistrimeve në bazën e njësuar CONOR
- LC/NAF kërkimi i regjistrimeve në bazën e njësuar LC/NAF
- SGC kërkimi i regjistrimeve në bazën e njësuar SGC
- ISSN kërkimi i regjistrimeve në bazën bibliografike ISSN
- CORES kërkimi i regjistrimeve në bazën CORES
- Arkivi COBIB kërkimi i regjistrimeve në bazën arkivore për COBIB
- Arkivi CONOR kërkimi i regjistrimeve në bazën arkivore për CONOR
- Arkivi SGC kërkimi i regjistrimeve në bazën arkivore për SGC
- Regjistrimet e fshira kërkimi i regjistrimeve të fshira

Disa biblioteka brenda listës kanë në dispozicion edhe bazën e të dhënave METADAT. Veprimet me regjistrimet nga kjo bazë e të dhënave janë përshkruar në kapitullin METADAT.

Kur në listë përzgjidhni bazën tjetër të të dhënave, dritarja për kërkim përshtatet (disa butona mungojnë, fusha për kërkimin e avancuar tek disa baza nuk është aktive etj.).

Baza e përzgjedhur e të dhënave mbetet e njëjtë, derisa dritaren për kërkim e hapni pa u shkëputur nga aplikacioni COBISS Cat.



Baza e të dhënave Katalogu LC, WorldCat dhe LC/NAF shfaqen në listë vetëm nëse keni autorizimet për shkarkimin e regjistrimeve nga ato.

#### 2.1.2 Shënimi i pyetjes për kërkim (kërkimi i specializuar + skanimi)

Në fushë shënoni pyetjen për kërkim në sintaksën e duhur (shih manualin COBISS3/Katalogimi, kap. 4.2). Tek kërkimi i specializuar mund të përdorni parashtesat dhe prapashtesat për kërkim, ndërsa në vend të parashtesave për kërkim mund të përdorni edhe shenjën e fushës dhe nënfushës ose shenjën e fushës me shkurtesën "ind" dhe shenjën e treguesit (skanimi).

🗹 Shembuj

LA=alb AND AU=Tolstoi\*

PU=Toena NOT 001b=a

(gjuha shqipe AND gramatika)/ART

PU=Dituria\* AND 101ind1=1 AND (205a=\*ribotim\* OR 205b=\*ribotim\*)

Pyetjet për kërkim edhe mund t'i kombinoni, duke i shënuar ato në fushën tek kërkimi i specializuar dhe tek fushat e veçanta te kërkimi i avancuar. Midis tyre gjatë kërkimit respektohet operatori logjik AND.

## A Shënime

Tek baza Katalogu LC, WorldCat dhe LC/NAF fusha për shënimin e të dhënave për kërkimin e specializuar dhe skanimin nuk është aktive.

Tek bazat arkivore në fushën për shënimin e të dhënave mund të shënohet vetën numri identifikues i regjistrimit nga baza COBIB, CONOR ose SGC.

### 2.1.3 Pasqyra e termave

Gjatë përpilimit të pyetjeve për kërkim, të cilat dëshironi t'i shënoni në fushat për kërkim, mund të përdorni

funksionin pasqyra e termave. Nëse klikoni butonin 🧭, hapet dritarja me listën e termave për kërkim, të cilët ndodhen aktualisht në bazën e të dhënave.



## 2.1.4 Parashtesat dhe prapashtesat për kërkim

Gjatë shënimit të pyetjes për kërkim mund të përdorni listën e parashtesave dhe prapashtesave për kërkim, si dhe

prapashtesave për kufizim, të cilat shfaqen duke klikuar në butonin <sup>2</sup>. Lista e të gjitha indekseve për kërkim, që përdoren në bazat bibliografike të të dhënave, në bazat e njësuara, në bazën e të dhënave CORES dhe atë të ISSN-së, ndodhet në kap. 6.

⚠ Shëni	m
Tek baza	t: Katalogu LC, WorldCat, LC/NAF dhe bazat arkivore, nuk është në dispozicion
butoni	P
Tek baza	t: Katalogu LC, WorldCat, LC/NAF dhe bazat arkivore, nuk është në dispozicion
butoni	?

## 2.1.5 Përzgjedhja e fushës për kërkim (kërkimi i avancuar)

Në dispozicion janë tri fusha për kërkim. Fushat e paracaktuara për kërkim mund t'i ndryshoheni duke përzgjedhur në listë fushën tjetër. Renditjen e ndryshuar të fushave për kërkim, në të cilat nuk ka pyetje të shënuara për kërkim,

mund ta ruani (butoni ). Renditja e fushave për kërkim ruhet edhe pasi ta mbyllni dritaren për kërkim dhe është e lidhur me emrin e përdoruesit.



## 2.1.6 Përzgjedhja e operatorëve shtesë

Pyetjet për kërkim mund të kufizohen me përdorimin e operatorëve shtesë: EMPTY, NOT, NOTEMPTY. Shih manualin COBISS3/Katalogimi, kap. 4.1.3.

## **∠!∖** Shënim

Tek bazat: Katalogu LC, WorldCat dhe LC/NAF operatorët shtesë nuk janë në dispozicion.

#### 2.1.7 Shënimi i pyetjes për kërkim (kërkimi i avancuar)

Në fushë shënoni pyetjen për kërkim. Midis pyetjeve për kërkim si i paracaktuar respektohet operatori logjik AND.

Kërkimin e specializuar dhe atë të avancuar mund t'i kombinoni, duke shënuar pyetjet për kërkim në fushën tek kërkimi i specializuar dhe në fushat e caktuara tek kërkimi i avancuar. Gjatë kërkimit midis tyre në mënyrë automatike respektohet operatori logjik AND.



Duke klikuar në butonin **q** filloni kërkimin.

Programi fillon kërkimin në bazën lokale të të dhënave (kur hapni ndërfaqen për katalogim baza lokale është baza e paracaktuar) ose në atë bazë, të cilën e keni përzgjedhur para kërkimit.

Nëse kërkimin e keni filluar në bazën lokale të të dhënave, pyetjen e shënuar për kërkim mund ta përdorni edhe në COBIB ose në bazat e përbashkëta të të dhënave në rrjetin COBISS.net. Në këtë rast vetëm përzgjidhni bazën, pa pasur nevojë të përdorni butonin



Nëse keni vendosur numrat identifikues të regjistrimeve (butoni **Lista e ID-ve**), fillon kërkimi në bazën e përzgjedhur të të dhënave, mirëpo vetëm për regjistrimet, numrat identifikues të të cilëve janë shtuar në listë.

## 2.1.9 Kërkimi i ri

Pyetjet e shënuara për kërkim dhe rezultatet e kërkimit i fshini nëse klikoni në butonin

#### 2.1.10 Kërkimi i fundit

Pyetjet për kërkim ruhen në mënyrë automatike. Nëse klikoni në butonin hapet dritarja **Historia e kërkimeve**. Në krye të listës ndodhet pyetja për kërkim, e cila është përdorur së fundmi. Nëse përzgjidhni pyetjen për kërkim, kërkimi ekzekutohet në mënyrë automatike pasi të klikoni në butonin **Në rregull**.



### 2.1.11 Shtimi i fushës për kërkim

Për shtimin e fushave për kërkim tek kërkimi i avancuar klikoni butonin ———. Mund t'i shtoni të gjitha fushat që janë në dispozicion.



#### 2.1.12 Shndërrimi i pyetjes për kërkim

Pyetjen për kërkim fillimisht mund ta formoni me ndihmën e fushave për kërkim në kërkimin e avancuar, më pas

klikoni butonin <sup>=></sup>. Pasi të klikoni në atë buton programi transferon dhe shdërron pyetjen për kërkim në sintaksën e duhur për kërkimin e specializuar (para termave për kërkim janë parashtesat, ndërsa mes vete lidhen përmes operatorëve logjik dhe ata të kontekstit). Më pas pyetjen për kërkim mund ta plotësoni ose ta riformuloni, para se të filloni kërkimin.



### 2.1.13 Largimi i fushës për kërkim

Për largimin e fushës për kërkim tek kërkimi i avancuar klikoni butonin 💌 .

Shënim Butoni nuk është në dispozicion tek bazat arkivore.

## 2.1.14 Lista e ID-ve

Për kërkim të mëtejshëm mund të përdorni listat me numrat identifikues (ID). Ata vendosen në dritaren **Lista e ID-ve** dhe mes tyre ndahen me presje, hapësirë ose rresht të ri.



#### 2.1.15 Klasifikimi i rezultateve të kërkimit

Mund të përcaktoni të dhënën, në bazë të së cilës do të klasifikohen rezultatet e kërkimit (p.sh. COBISS.AL-ID, viti i botimit, botuesi etj.). Si i paracaktuar është klasifikimi i regjistrimeve sipas numrit ngritës të COBISS.AL-ID.

Nëse klikoni butonin 👎 , ndryshoni mënyrën e klasifikimit në rend zbritës (butoni 🧜 ).



#### 2.1.16 Ruajtja e pyetësorit

Pyetjet për kërkim mund t'i ruani për t'i përdorur më vonë. Fillimisht shënoni pyetjen për kërkim, më pas klikoni

butonin E. Hapet dritarja **Ruaj pyetësorin**, në të cilën e vendosni emrin e pyetësorit. Pyetësori shtohet në listën tek "Pyetësorët e mi". Ruajtja e pyetësorëve është e lidhur me emrin e përdoruesit.

Renditjen e fushave për kërkim mund ta ndryshoni (nëse në to nuk ka pyetje të shënuara për kërkim). Nëse klikoni

butonin , renditja e fushave për kërkim pas mbylljes së dritares ruhet dhe mbetet e njëjtë derisa të mos e ndryshoni dhe ruani përsëri. Ndryshimi i renditjes së fushave për kërkim lidhet me emrin e përdoruesit.

#### 2.1.17 Redaktimi i pyetësorit

Pyetësorin mund ta riemëroni ose fshini (butoni 📍 tek lista "Pyetësorët e mi").

#### 2.1.18 Transferimi në skedarin tekst

Regjistrimet nga lista e rezultateve të kërkimit mund t'i transferoni në skedarin tekst (butoni ). Të dhënat më pas mund t'i importoni në programe të ndryshme për përpunimin e të dhënave (p.sh. MS Excel).



#### 2.1.19 Përzgjedhja e formatit të listës së rezultateve të kërkimit

Mund të përzgjidhni formatin në të cilin dëshironi të shfaqni listën e regjistrimeve të gjetura. Formati i fundit i përzgjedhur ruhet dhe merret në konsideratë tek kërkimet në vazhdim, derisa nuk e ndryshoni atë.

Për të gjitha burimet është i definuar paraprakisht formati i paracaktuar dhe formati për shkarkimin e regjistrimeve bibliografike. Tek regjistrimet e njësuara është i definuar paraprakisht vetëm formati i paracaktuar.

Llojet e ndryshme të formateve të listës së rezultateve të kërkimit mund t'i definoni edhe vet (butoni 🤔).

## A Shënim

Tek bazat: Katalogu LC, WorldCat dhe LC/NAF nuk mund të përzgjidhni formatin e listës së rezultateve të kërkimit.

## 2.1.20 Formatet e listës së rezultateve të kërkimit

Formatin e listës së rezultateve të kërkimit mund ta definoni vet dhe më vonë mund ta redaktoni (ta ndryshoni ose ta fshini). Shih manualin COBISS3/Katalogimi, kap. 12.1.2, 12.1.3.



## 2.1.21 1000 të tjera

Kur programi gjen më shumë se 100 regjistrime, të cilat i përshtaten pyetjes së shënuar për kërkim, në listën e rezultateve të kërkimit shfaqen vetëm 100 regjistrimet e para. Shfaqjen e 1000 regjistrimeve të tjera mund ta bëni duke klikuar në butonin **1000 të tjera**.

# **⚠ Shënim**

Gjatë kërkimit në bazat Katalogu LC, WorldCat dhe LC/NAF tek lista e rezultateve të kërkimit mund t'i shfaqni vetëm 100 regjistrime (butoni **100 të tjera**).

## 2.1.22 Rezultatet e kërkimit

Në pjesën e poshtme të dritares për kërkim shfaqet lista e regjistrimeve të gjetura në formatin e paracaktuar të listës së rezultateve të kërkimit apo në formatin që e keni përzgjedhur herën e fundit.

Rezultatet e shfaqura të kërkimit mund t'i klasifikoni sipas kritereve të ndryshme, të ndryshoni renditjen ose gjërësinë e kolonave:

- Të dhënat **i klasifikoni** duke klikuar në emrin e kolonës. Të dhënat klasifikohen në rend ngritës ose zbritës, në renditje alfabetike ose numerike.
- Për të **ndryshuar** renditjen e kolonave klikoni me tastin e majtë të miut në kolonë dhe tërhiqeni atë në të majtë ose në të djathtë.
- Për të **ndryshuar** gjërësinë e kolonës klikoni me tastin e majtë të miut në njërin skaj të kolonës dhe tërhiqeni atë në të majtë ose në të djathtë. Nëse dëshironi që kolonën ta zgjeroni më shumë se sa që është në mënyrë

automatike e paracaktuar, tek parametrat e përdoruesit (butoni <sup>2</sup>) zbrazeni kutinë e zgjedhjes *Gjerësia e kufizuar e kolonës në dritaren për kërkim*.

Në listën e regjistrimeve të gjetura regjistrimin (ose disa regjistrime) e përzgjidhni duke klikuar në kutinë e zgjedhjes (♥) pranë numrit në vazhdim të regjistrimit. Nëse në listë ndodhet vetëm 1 regjistrim i gjetur, kutia e zgjedhjes tek ky regjistrim është e klikuar në mënyrë automatike. Nëse dëshironi të përzgjidhni apo të pastroni të gjitha kutitë e zgjedhjes, të cilat ndodhen në listën e rezultateve të kërkimit, klikoni kutinë e zgjedhjes tek "Nr.".

# **Përzgjedhja e rezultateve të kërkimit**

Rezultatet në dritaren për kërkim i përzgjidhni në këtë mënyrë:

- fillimisht shtypni dhe mbani të shtypur tastin <Ctrl>, klikoni rreshtin me rezultatin e kërkimit, i cili duhet të jetë i pari në grupin e rezultateve të përzgjedhura (nuk duhet të klikoni në kutinë e zgjedhjes pranë numrit rendor)
- më pas shtypni dhe mbani të shtypur tastin <Shift>, klikoni rreshtin me rezultatin e kërkimit, i cili duhet të jetë i fundit në grupin e rezultateve të përzgjedhura.

Duke përsëritur këtë procedurë mund të përzgjidhni disa grupe të rezultateve të kërkimit (p.sh. nga 3 deri 10 dhe nga 15 deri 20).

## 2.1.23 Shtimi i regjistrimit në hapësirën e punës

Në listën e regjistrimeve të gjetura përzgjidhni regjistrimin e caktuar (ose disa regjistrime njëherësh) dhe atë shtojeni në hapësirën e punës duke klikuar në butonin **Shto**.

## 2.1.24 Redaktimi i regjistrimit

Regjistrimin e përzgjedhur e ngarkoni në redaktuesin e regjistrimit duke klikuar butonin **Redakto**. Regjistrimi në të njëjtën kohë ngarkohet në hapësirën e punës dhe shfaqet në paraqitës. Nëse keni përzgjedhur disa regjistrime, në redaktues ngarkohet regjistrimi i parë, ndërsa regjistrimet e tjera ngarkohen në hapësirën e punës. Shih edhe kap. 2.2.13.



Tek bazat Katalogu LC, WorldCat, ISSN, LC/NAF dhe bazat arkivore për COBIB, CONOR e SGC butoni **Redakto** nuk është aktiv.

### 2.1.25 Regjistrimi i ri

Për të krijuar një regjistrim klikoni butonin **Regjistrimi i ri**. Hapet dritarja **Regjistrimi i ri**, në të cilën fillimisht përzgjidhni bazën e duhur të të dhënave dhe maskën për shënimin e të dhënave. Më pas në redaktues ngarkohet regjistrimi me fushat dhe nënfushat e zbrazëta, me vlerat e paracaktuara nga maska e përzgjedhur e shënimit të të dhënave. Nëse paraprakisht keni përcaktuar modelin për regjistrimin e ri, atë mund ta përzgjidhni në të njëjtën dritare. Sapo të përzgjidhni modelin, në redaktues ngarkohet përmbajtja e tij.

Nëse tek **Modeli** klikoni kutinë e zgjedhjes **Shfaq të gjitha**, shfaqen modelet e të gjithë kataloguesve të bibliotekës së njëjtë. Nëse kutia e zgjedhjes është e zbrazët shfaqen vetëm modelet që i keni krijuar ju. Para emrave të modeleve, në mënyrë automatike shtohen edhe emrat e përdoruesit të kataloguesve, të cilët i kanë përgatitur modelet (p.sh. *MIRLONAB: E-artikull, ARTAK: default*).

## 🗥 Shënim

Maska për shënimin e të dhënave tek bazat e veçanta mbetet e përzgjedhur derisa nuk e ndryshoni atë.

### 2.1.26 Shfaqja e regjistrimit në dritaren për kërkim

Për t'i kontrolluar regjistrimet nga lista e rezultateve të kërkimit duhet t'i përzgjidhni ato dhe të klikoni butonin

Shfaq. Hapet kontrolluesi, në të cilin verifikoni regjistrimin në formatin COMARC (butoni 📕 ) ose në formatin

standard (butoni 🧖). Regjistrimet nga bazat e huaja mund t'i verifikoni në formatin origjinal (butoni MARC21)

ose në formatin COMARC (butoni **COMARC**). Nga njëri regjistrim tek tjetri mund të lëvizni përmes butonit

dhe butonit

Në kontrollues regjistrimin mund ta fshini nga baza e të dhënave (butoni **b**, ta shtoni në hapësirën e punës (butoni **Shto**) ose ta shfaqni në skedën e re të shfletuesit (butoni **Hap në skedën e re**).

Nëse në regjistrimin e përzgjedhur janë të lidhur edhe regjistrimet e tjera, objektet e lidhura mund t'i shikoni në pjesën e poshtme të kontrolluesit.

Tek regjistrimet bibliografike shfaqen objektet e lidhura me:

- burimin (nga regjistrimi për artikullin)
- burimet në vazhdim në lidhshmëri (nga regjistrimi për burimin në vazhdim)
- regjistrimet për pjesët përbërëse (nga regjistrimi për monografinë apo regjistrimi për burimin në vazhdim)
- regjistrimet e njësuara
- regjistrimet arkivore (vetëm për regjistrimet bibliografike nga baza e të dhënave COBIB)
- ELINKS

Tek regjistrimet e njësuara nga baza CONOR shfaqen objektet e lidhura me:

- pikëqasjet në lidhshmëri
- regjistrimet e lidhura bibliografike
- regjistrimet arkivore

Tek regjistrimet e njësuara nga baza SGC shfaqen objektet e lidhura me:

- termat në lidhshmëri
- termat e gjerë
- termat e ngushtë
- regjistrimet e lidhura bibliografike
- regjistrimet arkivore

Nëse klikoni në regjistrimin e shfaqur midis objekteve të lidhura, ai hapet në një dritare të re të kontrolluesit.

Tek një lloj i objekteve të lidhura shfaqen më së shumti 5 regjistrime. Të gjitha regjistrimet mund t'i shikoni, nëse klikoni në tri pikat nën listën e veçantë, me çrast hapet dritarja për kërkim me pyetjen e shënuar për kërkim dhe rezultatet e kërkimit.



## 2.1.27 Shfaqja e regjistrimeve në COBISS+

Regjistrimet bibliografike ose të njësuara, të cilat i keni përzgjedhur në listën e rezultateve të kërkimit, mund t'i hapni në COBISS+ (butoni **Shfaq në COBISS+**). Regjistrimi shfaqet në një skedë të re të shfletuesit.



Regjistrimet nga bazat: Katalogu LC, WorldCat, ISSN, LC/NAF dhe bazat arkivore nuk mund të shfaqen në COBISS+.

## 2.1.28 Krahasimi i regjistrimeve në dritaren për kërkim

Nëse dëshironi që regjistrimet t'i krahasoni me njëri-tjetrin, përzgjidhni regjistrimin në hapësirën e punës, më pas në listën e rezultateve të kërkimit përzgjidhni një ose disa regjistrime dhe klikoni butonin **Krahaso**. Hapet dritarja me ndryshimet, ku në anën e majtë të dritares gjithmonë ndodhet regjistrimi nga hapësira e punës, ndërsa në anën e djathtë ndodhen regjistrimet e përzgjedhura nga lista e rezultateve të kërkimit.

Nëse klikoni në butonin **Shto** regjistrimin mund ta shtoni në hapësirën e punës, ndërsa nëse klikoni në butonin **Hap në skedë të re** regjistrimin e shfaqni në një skedë të re të shfletuesit.

## **V** Këshillë

Edhe regjistrimet që ndodhen në hapësirën e punës mund t'i krahasoni mes vete (klikoni butonin

dhe përzgjidhni mundësinë **Krahaso**).

Nëse dëshironi të evitoni numrin e madh të skedave në shfletues dhe kalimin nga njëra skedë tek tjetra, regjistrimin mund ta shfaqni në dritaren e re të shfletuesit në vend të skedës së re. Këtë e bëni duke klikuar skedën dhe përmes butonit të majtë të miut e tërhiqni atë nga dritarja e shfletuesit në dritaren e re. Në këtë mënyrë keni qasje në disa regjistrime njëherësh.

### 2.1.29 Verifikimi i dublikatave

Duke klikuar në butonin **Verifiko dublikatat** mund të verifikoni nëse ekziston mundësia që regjistrimi të jetë dublikat i ndonjërit prej regjistrimeve në COBIB. Regjistrimin fillimisht duhet ta përzgjidhni në hapësirën e punës, më pas tek kërkimi i specializuar në fushën për shënimin e të dhënave në mënyrë automatike shënohet pyetja për kërkim, në bazë të së cilës bëhet verifikimi i dublikatave. Procedurën për verifikimin e dublikatave e konfirmoni duke klikuar në butonin

## 🗥 Shënim

Dublikatat e mundshëm mund të verifikohen vetëm për regjistrimet bibliografike nga baza lokale e të dhënave, COBIB-i ose COBISS.net.

### 2.1.30 Lidhja e regjistrimeve

Duke klikuar në butonin **Lidh** disa regjistrime bibliografike nga COBIB-i mund të lidhni njëherësh me regjistrimet e njësuara CONOR ose SGC.

Në bazën CONOR ose SGC fillimisht gjeni regjistrimin e njësuar përkatës, e shtoni atë në hapësirën e punës dhe e përzgjidhni. Më pas në dritaren për kërkim përzgjidhni bazën COBIB dhe klikoni butonin **Lidh**. Në fushën për kërkimin e specializuar në mënyrë automatike vendoset pyetja për kërkim, bazuar në pikëqasjen nga regjistrimi i njësuar, të cilin e keni përzgjedhur. Pyetjen për kërkim mund ta ndryshoni. Në listën e rezultateve të kërkimit përzgjidhni një ose disa regjistrime bibliografike, të cilat dëshironi t'i lidhni me regjistrimin e njësuar të përzgjedhur dhe përsëri klikoni butonin **Lidh**. Hapet dritarja për lidhje. Në pjesën e sipërme të dritares në formatin COMARC/B shfaqet regjistrimi i parë nga regjistrimet e përzgjedhura, ndërsa në pjesën e poshtme të dritares janë të shfaqura fushat 7XX apo 60X nga regjistrimi bibliografik, i cili është në pjesën e sipërme të dritares, dhe simboli + që mundëson lidhjen me regjistrimin shtesë të njësuar. Tek fushat ekzistuese 60X ndodhet edhe fusha 60X, të cilën mund ta shtoni në regjistrim.

COBIB	ID=39965 M V03 25.09.1989 NUBK::GJYLYMSERE-COBIBSR Updated:					
04.02.2	019 BPGJ::SYS_ARJETAS COBISS.Net: 11.07.2012 KNTAL::COSERVISAL C3					
000	a00103 b1989092520190204 cNUBK::GJYLYMSERE-COBIBSR					
	dBPGJ::SYS_ARJETAS eL1100 f0 g16982 m20120711 nKNTAL::COSERVISAL tC3					
001	ac – regjistrim i redaktuar ba – material tekst, i shtypur cm – monografi d0 –					
	nuk ka lidhje hierarkike <mark>7</mark> vv – disa shkrime					
100	c1989 halb – shqipe ib1 – * transliterimi COBISS për shkrimin cirilik Iba – latin					
101 <mark>0</mark>	aalb - shqipe					
102	axks – Kosova					
200 0	aÇështje te onomasiologjisë fitonimike romane dhe ballkanike fShefki Sejdiu					
210	aPrishtinë cRilindja d1989 ePrishtinë g"Rilindja"					
215	a314 fq. d19 cm.					
225 <mark>2</mark>	a Linguistike					
300	a Tirazhi 1000					
320	aIndeksat: fq.259-[294]					
320	a Bibliografia me shkurtesa:fq.295-312					
606 1	aOnomastika y Kosovo					
675	a809.198.3-73:57 c81 – Gjuhësia dhe gjuhët					
675	a57:809.198.3-73 c81 – Gjuhësia dhe gjuhët					
700 1	aSejdiu bShefki 4070 – autor					
✓ 700	: Seidiu. Shefki ⇒ 9354086: Seidiu. Shefki: 070					
+	~					
<	1 / 12 > Lidh Shto Mbyll					

Lidhja në paketë e fushave 7XX

Nëse dëshironi të lidhni ose të shtoni fushën 7XX apo 60X, e përzgjidhni atë dhe më pas klikoni butonin **Lidh**. Me këtë rast në regjistrimin bibliografik shtohet nënfusha 3 me numrin identifikues të regjistrimit të njësuar dhe pikëqasjen nga regjistrimi i njësuar (tek fushat 60X shtohet edhe nënfusha 2 me vlerën "*SGC*"), në dritare ngarkohet versioni i ri i regjistrimit, ndërsa butoni **Lidh** është joaktiv. Regjistrimi ruhet në COBIB.

Nëse dëshironi në regjistrim të shtoni lidhjen me regjistrim e njësuar shtesë, nga lista përzgjidhni fushën përkatëse, në dritaren **Kërkimi në CONOR** apo **Kërkimi në SGC** gjeni dhe përzgjidhni pikëqasjen përkatëse të njësuar, si dhe klikoni butonin **Lidh**. Me këtë rast në regjistrimin bibliografik shtohet nënfusha 3 me numrin identifikues të regjistrimit dhe pikëqasja nga regjistrimi i njësuar (tek fushat 60X shtohet edhe nënfusha 2 me vlerën "*SGC*"), në dritare ngarkohet versioni i ri i regjistrimit, ndërsa butoni **Lidh** është joaktiv. Regjistrimi ruhet në COBIB.

Nëse dëshironi të lidhni ndonjërin nga regjistrimet bibliografike, të cilat i keni përzgjedhur nga lista e rezultateve të

kërkimit, klikoni butonin C dhe përsëriteni procedurën. Duke klikuar në butonin ktheheni në regjistrimin e mëparshmëm.

Regjistrimin mund ta shtoni edhe në hapësirën e punës (butoni Shto).

Për të përfundar lidhjen ose për të ndërprerë procedurën klikoni butonin Mbyll.

## A Shënime

Për lidhjen në paketë të regjistrimeve bibliografike me regjistrimet e njësuara CONOR ose SGC nevojitet autorizimi CAT\_LINKAU. Ndërsa për lidhjen e regjistrimeve SGC nevojitet edhe autorizimi CAT\_SUBLINK.

Regjistrimet e njësuara të përzgjedhura për t'u fshirë oso që janë në përpunim (SGC), regjistrimet referuese dhe regjistrimet e përgjithshme shpjeguese, nuk mund të lidhen me regjistrimet bibliografike.

#### 2.1.31 Tipologjia

Nëse klikoni në butonin **Tipologjia** në regjistrimet nga COBIB-i mund të verifikoni tipologjinë. Nëse dëshironi të konfirmoni tipologjinë klikoni butoni **Blloko**, ndërsa nëse dëshironi të ndryshoni tipologjinë tashmë të konfirmuar, klikoni butonin **Zhblloko**. Regjistrimin mund ta shtoni edhe në hapësirën e punës (butoni **Shto**).

## **⚠ Shënime**

Për verifikimin e tipologjisë nevojitet autorizimi CAT\_LOCKTD.

Kur nënfusha me tipologji bllokohet, ndryshimi i përmbajtjes së fushës 970 nuk është i mundur.

## 2.1.32 Bibliografitë

Bibliografitë dhe listat e emërtimeve lëndore mund t'i përgatisni nga dritarja për kërkim (butoni **Bibliografitë**). Përpara se të shtypni butonin **Bibliografitë**, në dritaren për kërkim mund të shënoni pyetjen për kërkim dhe më pas filloni kërkimin në bazën lokale ose COBIB.

## 2.1.32.1 Përgatitja e bibliografive

Filloni nga dritarja Bibliografitë, emërtimet lëndore..., ku fillimisht përzgjidhni llojin e raportit.

1. Klikoni butonin **Përgatit raportin**.

Hapet dritarja **Parametrat e raportit**.

Nëse në dritaren për kërkim keni shënuar pyetjen për kërkim dhe keni filluar kërkimin në bazën lokale ose në COBIB, baza e përzgjedhur e të dhënave dhe pyetja për kërkim transferohen në mënyrë automatike në dritaren **Parametrat e raportit** (vlenë vetëm për raportet nga grupet BIB001, BIB002, BIB051). Nëse fillimisht nuk e keni ekzekutuar kërkimin (ose keni përzgjedhur llojin e raportit tjetër nga BIB001, BIB002, BIB051), tek "Burimi" duhet të përzgjidhni bazën e duhur dhe të përcaktoni vlerat e parametrit "Kërkimi i specializuar" duke shënuar pyetjen për kërkim për përzgjedhjen e materialit tek "Redakto pyetësorin".

 Përcaktoni edhe vlerat e parametrave të tjerë për përgatitjen e bibliografisë. Tek "Formati i njësisë bibliografike" nga lista mund të përzgjedhni edhe formatin, të cilin e keni përcaktuar dhe emëruar vet, shih kap. 2.1.33.

Tek "Adresa elektronike" në mënyrë automatike vendoset adresa elektronike bazuar në emrin e përdoruesit. 3. Klikoni butonin **Në rregull**.

Nëse fusha tek "Adresa elektronike" është e zbrazët, bibliografia hapet në shfletuesin e internetit bazuar në formatin e përzgjedhur të raportit. Skedarin mund ta ruani në kompjuterin tuaj.

Nëse fusha tek "Adresa elektronike" nuk është e zbrazët, skedarin e merrni në adresën elektronike.

## 🗥 Shënim

Përgatitja e bibliografive me shumë njësi mund të zgjasë më shumë.

Raporti *BIB051: Raporti CIP* është në dispozicion vetëm në bibliotekat, të cilat përgatisin raporte të regjistrimeve CIP.

Në të njëjtën mënyrë përgatiten raportet për bibliografitë dhe listat e emërtimeve lëndore edhe në aplikacionin COBISS Lib, moduli **Raportet**, skeda **Bibliografitë**.

### 2.1.32.2 Qasja në skedarët e ruajtur me raportet

Bibliografitë e përgatitura mund t'i ruani për t'i përdorur më vonë.

Në dritaren **Bibliografitë, emërtimet lëndore...**, fillimisht përzgjidhni llojin e raportit, të cilin dëshironi ta përgatisni.

- 1. Klikoni butonin **Shfleto raportet e përgatitura**. Hapet dritarja **BIBXXX**.
- 2. Përzgjidhni skedarin e duhur.
- 3. Klikoni butonin Hap.
- 4. Skedarin e përzgjedhur mund edhe ta riemërtoni. Shenja e përcaktimit të përzgjedhur në fillim të emrit është e dhënë e pandryshueshme.
- 5. Skedarin e përzgjedhur mund ta fshini nga lista e raporteve të ruajtura. Mund të përzgjidhni disa skedarë njëherësh.

## 2.1.33 Formatet e përdoruesit për bibliografitë

Në aplikacionin COBISS Lib në modulin **Raportet** përcaktoni formatet me të dhëna të ndryshme bibliografike dhe të dhëna të tjera, të cilat mund t'i përdorni në bibliografi.

## 2.1.33.1 Përgatitja e formateve të përdoruesit

Në aplikacionin COBISS Lib, moduli **Raportet**, përzgjidhni skedën **Bibliografitë**. Hapet dritarja **Bibliografitë**, **emërtimet lëndore...**, në të cilën fillimisht përzgjidhni njëren nga grupet (p.sh. BIB001, DSC001...) dhe klikoni butonin **Formatet e përdoruesit për bibliografitë**. Hapet dritarja **Redaktimi i formateve të përdoruesit** me listën e formateve të përcaktuara paraprakisht. Në fillim lista është e zbrazët.

## **⚠ Shënim**

Formatet e përcaktuara nuk janë të lidhura me emrin e përdoruesit, për këtë arsye ato mund t'i përdorin të gjithë kataloguesit e bibliotekës së veçantë.

### 2.1.33.1.1 Shtimi dhe ndryshimi i formateve të përdoruesit

Listën e formateve të përdoruesit mund ta plotësoni me formate të reja ose formatet ekzistuese mund t'i ndryshoni.

#### Filloni nga dritarja **Redaktimi i formateve të përdoruesit**.

- Për shtimin e formatit të ri të përdoruesit klikoni butonin Shto. Hapet dritarja Shto formatin e përdoruesit, në të cilën tek "Emri i formatit të përdoruesit" shënoni emrin e formatit.
- 2. Për ndryshimin e formateve aktuale, të përzgjedhura në listë, klikoni butonin **Redakto**. Hapet dritarja **Formatet e përdoruesit**.
- Përcaktoni elementet për formatin e përdoruesit.
   Nëse dëshironi që elementin ta shtoni midis elementeve për shfaqje, atë duhet ta përzgjidhni në listën "Të gjitha elementet" dhe klikoni butonin Shto. Elementet që përmbajnë nënelemente kanë simbolin e shigjetës. Mund të shtoni elemente ose nënelemente të pavarura.
   Nëse dëshironi që elementin ta largoni nga lista "Elementet e përzgjedhura", përzgjidheni atë dhe klikoni butonin Largoni.
- Klikoni butonin Ruaj, më pas Mbyll. Në dritaren Ruaj formatin e përdoruesit konfirmoni emrin duke klikuar në butonin Në rregull ose emrin e ndryshoni.

## 

Nëse përzgjidhni disa nënelemente brenda zonës ose grupit të njëjtë, të dhënat në bibliografi

## **K**ëshilla

Nëse dëshironi që formatin ekzistues ta ndryshoni dhe ta ruani me një emër të ri, klikoni butonin **Ruaj si**.

Nëse dëshironi të verifikoni listën e elementeve dhe të dhënave që do të shfaqen në bibliografi,

klikoni në butonin **?** 

#### 2.1.33.1.2 Fshirja e formateve të përdoruesit

Formatet e përdoruesit i fshini në dritaren Redaktimi i formateve të përdoruesit.

- 1. Në listën "Formatet e përdoruesit" përzgidhni formatin duke klikuar mbi të.
- 2. Klikoni butonin Fshi.

Programi kërkon që fshirjen e formatit ta konfirmoni.

3. Klikoni butonin Në rregull, më pas edhe Mbyll.

#### 2.1.34 Eksportimi i regjistrimeve

Nga lista e rezultateve të kërkimit mund të eksportoni një ose disa regjistrime në formate të ndryshme. Pasi t'i përzgjidhni regjistrimet dhe të klikoni butonin **Eksporto**, hapet dritarja **Eksporti i regjistrimeve**, nga lista përzgjidhni formatin (*MARC21, MARCXML, Dublin Core, COMARCXML, COMARC* ose *MODS*). Klikoni butonin **Përgatit** dhe më pas butonin me numrin e regjistrimeve për eksport.

Rezultat i eksportit është skedari, i cili në mënyrë automatike ruhet në dosjen *Downloads* në diskun lokal dhe zakonisht ruan emrin që e ofron programi. Mundësia e ndryshimit të lokacionit për ruajtjen e skedarit dhe vendosjen e një emri të ri për skedarin e ruajtur varet nga parametrat e shfletuesit të internetit. Shih edhe kap. 5.7.

Skedarin me regjistrimet e ruajtura nga eksporti mund ta hapni edhe në shfletuesin e internetit (ikona <sup>4</sup> lart në këndin e djathtë të shfletuesit). Skedari mund të jetë i tipit *mrc* (për regjistrimet në MARC 21), *xml* (për regjistrimet në MARC XML, Dublin Core, COMARCXML, MODS) ose *txt* (për regjistrimet në COMARC).

# \land Shënim

Për eksportin e regjistrimeve nevojitet autorizimi CAT\_EXPORT.

Eksporti i regjistrimeve bibliografike bëhet nga baza lokale e të dhënave dhe është i kufizuar në 10.100 regjistrime. Nëse eksportoni numrin maksimal të regjistrimeve (vlenë kryesisht për eksportet në MARC 21, MARCXML, Dublin Core) procedura e përgatitjes së skedarit mund të zgjasë (edhe më shumë se një orë).

#### 2.1.35 Lidhja e regjistrimeve lokale

Regjistrimet lokale janë regjistrime të ruajtura vetëm në disa nga bazat lokale të bibliotekave, por nuk ndodhen në COBIB. Identifikohen me fjalën »only«, e cila është e shënuar në nënfushën 000e në fushën e sistemit. Në shumicën e rasteve regjistrimet e tilla janë rezultat i konvertimit të tyre nga sistemi, të cilin biblioteka e ka përdorur para se të përfshihet në sistemin COBISS.

Procedura e lidhjes së regjistrimeve lokale mundëson zgjidhje të shpejt të problemit me këto regjistrime dhe

gjithashtu mundëson identifikimin e dublikatave të mundshme. Në këtë rast, ose regjistrimi lokal ruhet në COBIB, ose regjistrimi nga COBIB-i shkarkohet, ndërsa transferimi i të dhënave për koleksionet dhe fshirja e regjistrimit dublikat (lokal) bëhen në mënyrë automatike.

Regjistrimet lokale në hapësirën e punës kanë akronimin e bazës lokale dhe COBISS-ID, pas së cilës ndodhet fjala *[only]*.



Procedura e verifikimit dhe ruajtjes së regjistrimeve lokale në COBIB është në dispozicion vetëm në bibliotekat, të cilat në bazën e tyre kanë regjistrime lokale që nuk ndodhen në COBIB.

#### Procedura

- 1. Në bazën lokale të të dhënave gjeni regjistrimet, midis të cilëve ndodhen regjistrimet lokale dhe përzgjidhni ata.
  - Të gjitha regjistrimet lokale i gjeni përmes kërkimit të specializuar, ku shënoni: 000e = only.
- 2. Klikoni butonin Lidh regjistrimet lokale. Për çdo regjistrim ekzekutohet procedura e lidhjes, ku fillimisht verifikohet nëse në COBIB ekziston regjistrimi për burimin e njëjtë bibliografik. Hapet dritarja për kërkim, në të cilën tek kërkimi i specializuar transferohet në mënyrë automatike pyetja për kërkim, për gjetjen e regjistrimeve dublikatë në COBIB. Në pjesën e sipërme të dritares shfaqen numrat rendorë të regjistrimit nga lista e mëparshme e rezultateve dhe të dhënat elementare për regjistrimin lokal (COBISS-ID, të dhënat nga fusha 200 dhe 210acd), të cilin në këtë fazë të procedurës po e lidhni. Kandidatët e mundshëm për dublikatë shfaqen në listën e rezultateve të kërkimit.
- 3. Regjistrimin lokal mund ta kontrolloni në formatin COMARC (butoni **Shfaq regjistrimin lokal**) ose atë e shtoni në hapësirën e punës (butoni **Shto regjistrimin lokal**).
- 4. Nëse pyetja për kërkim e përcaktuar në mënyrë automatike nuk jep rezultate, duke klikuar në butonin **Kërkimi shtesë** mund të ekzekutoni një kërkim tjetër më të gjerë të regjistrimeve dublikatë. Nëse në këtë buton klikoni sërish, ju mund të ndryshoni edhe një herë pyetjen për kërkim të krijuar në mënyrë automatike. Pyetjen për kërkim mund ta ndryshoni edhe në mënyrë manuale.
- 5. Regjistrimet e gjetura në COBIB mund t'i përzgjidhni dhe t'i krahasoni me regjistrimin lokal (butoni

Krahaso). Nëpër regjistrimet në dritaren për krahasim mund të lëvizni përmes butonit 🍡 dhe 🥵

- 6. Nëse regjistrimi tashmë ndodhet në COBIB, atë e shkarkoni në bazën lokale (butoni **Përdor regjistrimin nga COBIB-i** në dritaren për krahasim). Në këtë rast koleksionet e bibliotekes transferohen në mënyrë automatike nga regjistrimi lokal në regjistrimin e saposhkarkuar, ndërsa regjistrimi lokal fshihet.
- 7. Regjistrimin nga COBIB-i mund ta shtoni në hapësirën e punës (butoni Shto në dritaren për krahasim).
- 8. Nëse regjistrimi për burimin e njëjtë bibliografik nuk ndodhet në COBIB, regjistrimin lokal mund ta ruani në COBIB (butoni **Ruaj në COBIB** në dritaren për kërkim ose në dritaren për krahasim).
- 9. Për lidhjen e regjistrimit tjetër lokal, në dritaren për kërkim të regjistrimeve dublikatë klikoni butonin

dhe procedurën e përsërisni. Nëse klikoni në butonin 📂 ktheheni në regjistrimin e mëparshëm.

10. Kur të përfundoni me lidhjen, klikoni butonin **Mbyll**. Përmes këtij butoni mund të ndërprisni procedurën kurdo që dëshironi.

## 2.2 Hapësira e punës

Hapësira e punës është pjesa e majtë e ndërfaqes për katalogim ku ngarkohen regjistrimet e gjetura në bazat e ndryshme të të dhënave dhe regjistrimet që krijohen ose redaktohen.

Regjistrimet në hapësirën e punës kanë akronimin e bazës së të dhënave, numrin identifikues të regjistrimit dhe të dhënat bazë. Regjistrimet lokale, të cilat ndodhen vetëm në bazat lokale dhe jo në COBIB, kanë fjalën *[only]*. Fillimisht regjistrimeve në mënyrë automatike u ndahet një numër në vazhdim, p.sh. -1, -2...<-n>, ndërsa kur të ruhen marrin numrin identifikues (COBISS.AL-ID ose CONOR.AL-ID etj.).

	2	
÷		×
COBISS.SI 12584020 Hall sensor, sensor assemb	ly inc	× Iuding
COBIB 1537955056	ørig	× ins to t
BASH 1537955056 History of Albania : from its	🥜 s orig	× ins to t
BASH -1	1	×
Katalogu LC 73005158 The jurisprudence of medic	ø tine.	×
CONOR 412774 Kadare, Ismail	. At	×
ISSN 623580 Dialektologjia shqiptare	ø	×
COBIB 6928903 Ftesë në studio	<b>A</b>	×

#### Hapësira e punës

Elementet e hapësirës së punës:

- 1. Butoni 🭳 🗹 që shfaq ose fsheh dritaren për kërkim
- 2. Butoni <sup>C</sup> për krijimin e regjistrimit të ri (është në dispozicion vetëm kur është aktiv redaktuesi)
- 3. Butoni eregjistrimit (është në dispozicion vetëm kur është aktiv redaktuesi)
- 4. Butoni <sup>(2)</sup> për shndërrimin e regjistrimit ekzistues në një regjistrim të ri (është në dispozicion vetëm kur është aktiv redaktuesi)
- 5. Butoni 🕈 për klasifikimin e regjistrimeve
- 6. Butoni për mundësitë shtesë: shfaqja e regjistrimit në kontrollues, krahasimi i regjistrimit, përzgjedhja e fushave për t'i transferuar, verifikimi i dublikatave, shfaqja e regjistrimit në COBISS+, shfaqja e listës së bibliotekave, marrja apo anulimi i përgjegjësisë për regjistrimin
- 7. Butoni 💌 për largimin e një ose disa regjistrimeve nga hapësira e punës
- 8. Butoni 🖉 për shtimin e regjistrimit në redaktues
- 9. Butoni <sup>\*</sup> për shkarkimin e regjistrimeve nga Svaroga (në dispozicion vetëm në NUK dhe kur është aktiv redaktuesi)

Kur të shtoni regjistrimin në redaktues, ikona në buton merr ngjyrë portokalli 🧷. Në redaktues mund të vendosen disa regjistrime njëherësh.

#### 2.2.1 Regjistrimi i ri

Regjistrimi krijohet duke klikuar në butonin Hapet dritarja **Regjistrimi i ri**, në të cilën fillimisht përzgjidhni bazën e të dhënave dhe maskën për shënimin e të dhënave. Më pas në redaktues ngarkohet regjistrimi me fushat dhe nënfushat e zbrazëta, me vlerat e paracaktuara nga maska për shënimin e të dhënave. Nëse paraprakisht keni definuar modelin për regjistrimin e ri, atë mund ta përzgjidhni në të njëjtën dritare, me ç'rast në redaktues ngarkohet përmbajtja nga modeli.

Nëse tek **Modeli** klikoni kutinë e zgjedhjes **Shfaq të gjitha**, shfaqen modelet e të gjithë kataloguesve të bibliotekës së njëjtë. Nëse kutia e zgjedhjes është e zbrazët shfaqen vetëm modelet që i keni krijuar ju. Para emrave të modeleve në mënyrë automatike shtohen edhe emrat e përdoruesit të kataloguesve, të cilët i kanë përgatitur modelet (p.sh. *MIRLONAB: E-artikull, ARTAK: default*).

## 🗥 Shënim

Maska për shënimin e të dhënave tek baza e veçantë mbetet e përzgjedhur derisa të mos e ndryshoni atë.



Regjistrimin mund ta krijoni edhe përmes kombinimit të tasteve <Ctrl> + <Alt> + <+>.

### 2.2.2 Fshirja e regjistrimit

Regjistrimin mund ta fshini nga baza lokale e të dhënave dhe/ose COBIB-i (butoni

# \land Shënime

Regjistrimet, me të cilat janë të lidhura regjistrimet e tjera në marrëdhënie hierarkike përmes numrit identifikues (nënfusha 4641), nuk mund t'i fshini. Mirëpo mund t'i' fshini ato, me të cilat janë të lidhura regjistrimet përmes numrit të ISSN-së (nënfushat 011as).

Nëse regjistrimi që fshini ndodhet edhe në ndonjë bazë tjetër lokale, fshihet vetëm nga baza juaj lokale, në të kundërtën fshihet edhe nga COBIB-i.

Regjistrimet e njësuara nuk mund të fshihen.

### 2.2.3 Përfto një regjistrim të ri

Nga regjistrimi ekzistues bibliografik ose i njësuar mund të përfitoni një regjistrim të ri. E përzgjidhni regjistrimin

në hapësirën e punës, më pas klikoni butonin <sup>(2)</sup>. Tek regjistrimet bibliografike hapet dritarja **Përzgjedhja e maskës**, në të cilën përzgjidhni maskën e duhur për shënimin e të dhënave. Regjistrimi, i cili është kopje e regjistrimit të përzgjedhur, ngarkohet në redaktues, ku plotësohet dhe ndryshohet.

# \land Shënime

Tek transferimi i përmbajtjes së regjistrimit të përzgjedhur bibliografik në redaktues nuk transferohen nënfushat 001e, 011ec, 017abdz2, 020abz, 021abz, 022abz, 70X9, dhe as fushat 992 e 993.

Në redaktues gjithashtu nuk transferohen fushat, të cilat përmbajnë nënfushën 5 me kodin e bibliotekave të tjera (fushat 012, 141, 316 etj.).

#### 2.2.4 Klasifikimi i regjistrimeve

Duke klikuar në butonin regjistrimet mund t'i klasifikoni në hapësirën e punës, dhe atë sipas kohës kur janë shtuar në hapësirën e punës, sipas renditjes alfabetike (fillimisht sipas akronimit të bazës, më pas tek regjistrimet bibliografike sipas titullit apo tek regjistrimet e njësuara sipas pikëqasjes) dhe sipas numrit identifikues të regjistrimit.

### 2.2.5 Shfaqja e regjistrimit në hapësirën e punës

Regjistrimin nga hapësira e punës mund ta shfaqni në formatin standard ose në formatin COMARC. Nëse

regjistrimi është nga baza e huaj e të dhënave shfaqet në formatin MARC 21 ose COMARC (klikoni butonin dhe përzgjidhni mundësinë **Shfaq**). Shih edhe kap. 2.1.26. Nëse në kontrollues ndodhet regjistrimi, i cili po redaktohet (ikona për të është lapsi në fillim të fushës së sistemit), ndryshimet që bëni duken. Gjendjen e regjistrimit para redaktimit e verifikoni duke klikuar kutinë e zgjedhjes tek *Regjistrimi fillestar me koleksione*. Në formatin COMARC shfaqen edhe fushat për koleksionet, nëse ato ekzistojnë.

Nëse në regjistrim ndodhen linqet për burimet në internet (p.sh. në nënfushën 856u), ata janë aktiv edhe në formatet e shfaqjes.

# 🖓 Këshillë

Regjistrimin në redaktues (regjistrimi i ri apo ekzistues) para se ta ruani mund ta verifikoni edhe në formatin standard.

Nëse midis parametrave të përdoruesit (butoni ) keni klikuar kutinë e zgjedhjes tek *Shfaq fushat për koleksionet*, në formatin COMARC shfaqen edhe fushat 996/997 dhe 998, mirëpo vetëm për regjistrimet që nuk ndodhen në redaktues.

### 2.2.6 Krahasimi i regjistrimit

Regjistrimet nga hapësira e punës mes vete mund t'i krahasoni duke klikuar në butonin dhe më pas duke përzgjedhur mundësinë **Krahaso**. Hapet dritarja me listën e regjistrimeve, të cilat janë në dispozicion për krahasim me regjistrimin e përzgjedhur. Në listë ndodhen të gjitha regjistrimet nga hapësira e punës (edhe ato, të cilat ndodhen në procedurën e redaktimit), dhe versioni i regjistrimit të përzgjedhur nga baza lokale e të dhënave ose nga COBIB-i.

Regjistrimin mund ta shfaqni në skedën e re të shfletuesit (butoni **Hap në skedë të re**), ose mund ta shtoni në hapësirën e punës (butoni **Shto**).

# **K**ëshillë

Regjistrimet që po redaktohen kanë ikonën e lapsit në dritaren për krahasimin e regjistrimeve.

### 2.2.7 Përzgjedhja e fushave për transferim në kujtesën e fragmenteve apo në redaktues

Nga regjistrimi në hapësirën e punës mund të kopjoni fushën me nënfushat përkatëse (klikoni butonin dhe përzgjidhni mundësinë **Përzgjedhja e fushave për transferim**). Në regjistrim përzgjidhni një ose disa fusha dhe klikoni butonin **Transfero në hapësirën e punës**, nëse dëshironi që fushat e përzgjedhura të transferohen në kujtesën e fragmenteve. Nëse dëshironi që fushat e përzgjedhura të shtohen në regjistrimin në redaktues, klikoni

butonin **Transfero në redaktues**. Nëse klikoni kutinë e zgjedhjes tek *Mbulo fushat ekzistuese*, fushat e përzgjedhura mbulojnë të gjitha fushat ekzistuese me shenjën e njëjtë, kur ato të transferohen në regjistrimin në redaktues.

Shih edhe kap. 2.3.7.

# Këshillë

Kopjimi i fushave mund të bëhet edhe për regjistrimet nga bazat e huaja të të dhënave.

# A Shënime

Butoni **Transfero në redaktues** dhe kutia e zgjedhjes tek *Mbulo fushat ekzistuese* nuk janë në dispozicion, kur është e përzgjedhur dritarja për kërkim ose kur në redaktues nuk ndodhet asnjë regjistrim.

Gjatë mbulimit të fushave ekzistuese në regjistrimin në redaktues duhet të keni kujdes veçanërisht kur të transferoni fushat e përsëritshme (p.sh. gjatë transferimit të fushës 702 në regjistrimin në redaktues fillimisht fshihen të gjitha fushat ekzistuese 702, më pas në të shtohet fusha 702, të cilin e keni përzgjedhur).

## 2.2.8 Verifikimi i dublikatave

Edhe regjistrimin në redaktues (regjistrim i ri apo ekzistues) mund ta verifikoni nëse është dublikat potencial i

ndonjërit nga regjistrimet në COBIB (klikoni butonin <sup>11</sup> dhe përzgjidhni mundësinë **Verifiko dublikatat**). Shih edhe kap. 2.1.29.

## 2.2.9 Shfaqja në COBISS+

Regjistrimin nga hapësira mund ta hapni në COBISS+ (klikoni butonin <sup>111</sup> dhe përzgjidhni mundësinë **Shfaq në COBISS**+).



Regjistrimet nga bazat: Katalog LC, WorldCat, ISSN, LC/NAF dhe bazat arkivore nuk mund të shfaqen në COBISS+.

## 2.2.10 Shfaqja e listës së bibliotekave

Nga hapësira e punës mund të kontrolloni se në cilat baza lokale të të dhënave ndodhet regjistrimi bibliografik

(klikoni butonin <sup>•••</sup> dhe përzgjidhni mundësinë **Shfaq listën e bibliotekave**). Hapet lista me akronimet, emrat e bibliotekave dhe adresat elektronike të personave të kontaktit për COBISS.

Për njoftim të mëtejshëm mund të shfaqni listën e adresave për kontakt (butoni **Adresat elektronike**) ose të transferoni në tërësi listën e bibliotekave (butoni **Shkarko**). Në rastin e parë përgatitet skedari *txt* me listën e adresave elektronike, ndërsa në të dytin skedari *csv*, të cilin mund ta hapni në Excel (në mënyrë që të dhënat të shfaqet në kolona, në menunë **Data** duhet të përdorni *Text to Columns*). Të dy skedarët ruhen në dosjen *Shkarkimet* apo *Downloads* në diskun lokal, ndërsa mund t'i hapni edhe në shfletues interneti.

## 2.2.11 Marrja ose anulimi i përgjegjësisë për regjistrimin

Për regjistrimin e njësuar biblioteka mund të marr përgjegjësinë ose atë përgjegjësi ta anuloj.

## \land Shënim

Për procedurën e marrjes apo anulimit të përgjegjësisë për regjistrimin ju nevojitet autorizimi CAT\_NEWPN ose CAT\_NEWCB.

Regjistrimin në hapësirën e punës e përzgjidhni, më pas klikoni butonin dhe përzgjidhni mundësinë **Merr/anulo përgjegjësinë për regjistrimin**. Shfaqet njoftimi se keni marr përgjegjësinë për regjistrimin. Nga ky moment e në vazhdim kataloguesit e bibliotekave të tjera në regjistrim mund të shtojnë vetëm të dhënat për variantet e pikëqasjeve, mirëpo nuk mund ta redaktojnë atë, përveç nëse kanë autorizimin CAT\_CONOR.

## \land Shënim

Nëse një bibliotekë ka marrë përgjegjësinë për regjistrimin, biblioteka tjetër nuk mund ta bëjë një veprim të tillë.

Në të njëjtën mënyrë edhe anuloni përgjegjësinë për regjistrimin. Kur merrni njoftimin se përgjegjësia për regjistrimin është anuluar, kataloguesit e tjerë mund ta redaktojnë sërish atë.

# \land Shënim

Nëse për regjistrimin është përgjegjëse një bibliotekë tjetër, anulimi i përgjegjësisë është i mundur vetëm nëse keni autorizimin CAT\_CONOR.

## 2.2.12 Largimi i regjistrimeve

Regjistrimet mbeten në hapësirën e punës, derisa të mos i largoni nga aty. Regjistrimet mund t'i largoni një nga një

ose të gjitha njëherësh. Nëse klikoni butonin 🕺 në pjesën e sipërme të hapësirës së punës, mund të largoni njëherësh të gjitha regjistrimet, pranë të cilave ndodhet butoni 🖍 (regjistrimet kanë qenë të ruajtura). Programi na paralajmëron se regjistrimet, të cilat ende nuk janë ruajtur (pranë tyre ndodhet butoni 🖍 ), nuk do të largohen nga hapësira e punës. Regjistrimet e tilla mund t'i largoni një nga një. Ndryshimet e bëra në regjistrim para këtij veprimi nuk ruhen.

## 2.2.13 Redaktimi i regjistrimit

Butonin 🖉 e përdorni nëse dëshironi që regjistrimin ta plotësoni ose ta shkarkoni në bazën tuaj lokale.

Duke klikuar në butonin 🖍 shtoni regjistrimin në redaktues. Në të njëjtën kohë shfaqet edhe në paraqitësin e regjistrimit. Ikona në buton merr ngjyrë portokalli 🖍, që do të thotë se regjistrimi për momentin është duke u redaktuar dhe nuk është në dispozicion për kataloguesit e tjerë. Në hapësirën e punës mund të keni disa regjistrime për t'i redaktuar (midis tyre lëvizni duke klikuar butonin 🏈). Të gjitha ndryshimet në regjistrimin ekzistues, të cilat nuk i keni ruajtur në bazën e të dhënave, do të fshihen në mënyrë automatike çdo ditë në ora 23:59, ndërsa regjistrimi do të jetë prap i disponueshëm për të gjithë kataloguesit (ngjyra e ikonës në buton do të ndryshoj nga portokalli në të zezë). Të gjitha regjistrimet e reja që nuk i keni ruajtur, mund të mbeten në hapësirën e punës për aq kohë sa ju dëshironi.

Butoni 💉 përdoret kur dëshironi:

- të redaktoni regjistrimin që ekziston në bazën lokale të të dhënave dhe në COBIB
- të redaktoni regjistrimin drejtpërsëdrejti në COBIB
- të redaktoni regjistrimin lokal
- të shkarkoni regjistrimin nga COBIB-i, COBISS.net, bazat e huaja të të dhënave (Katalogu LC, WorldCat, ISSN, LC/NAF)

Gjatë shkarkimit të regjistrimit nga baza Katalogu LC, WorldCat ose LC/NAF ikona në buton nuk merr ngjyrë portokalli. Në këtë rast në hapësirën e punës shtohet regjistrimi i ri nga baza e përzgjedhur, i cili ka akroniminin e bazës lokale dhe numrin identifikues të regjistrimit <-n>.

Nëse në hapësirën e punës përzgjidhni regjistrimin nga baza lokale e të dhënave, në redaktues ngarkohet versioni i fundit i regjistrimit nga COBIB-i. Nëse bëhet fjalë për redaktimin e regjistrimit COBISS2, programi ju njofton për këtë. Rekomandohet që fillimisht të verifikoni dallimet midis regjistrimit nga COBIB-i dhe atij nga baza lokale (butoni **Krahaso**). Nëse në regjistrimin nga baza lokale ekzistojnë fushat, të cilat dëshironi t'i transferoni në regjistrimin nga COBIB-i, mund të përzgjidhni fushat më nënfushat përkatëse dhe t'i transferoni ato në kujtesën e fragmenteve apo në redaktuesin e regjistrimit (butoni **Përzgjedhja e fushave për transferim**), shih edhe kap. 2.2.7. Kur të klikoni butonin **Në rregull**, mund të filloni redaktimin e regjistrimit.

## A Shënime

Kur në hapësirën e punës përzgjidhni regjistrimin nga baza lokale e të dhënave, në redaktues gjithmonë ngarkohet versioni i regjistrimit nga COBIB-i, mirëpo pa fushat me emërtimet lëndore dhe pa fushat për klasifikim. Këto fusha transferohen nga regjistrimi në bazën lokale, nëse ato ekzistojnë.

Në redaktues nuk mund të ngarkohet regjistrimi, të cilin në të njëjtin kohë po e redakton dikush tjetër (në COBISS3/Katalogimi ose COBISS Cat). Shfaqet njoftimi, se regjistrimi nuk është i disponueshëm dhe informacioni për kataloguesin që po e redakton atë.

### 2.2.14 Shkarkimi i regjistrimeve nga Svaroga

Shkarkimi i regjistrimeve nga Svaroga është i mundshëm në NUK (butoni 📩 ).

### 2.2.15 Paraqitja e regjistrimit

Në paraqitës mund të shfaqni regjistrimin nga hapësira e punës ose regjistrimin që ndodhet në redaktues. Regjistrimet në paraqitës i zëvendësoni në këto mënyra:

- për të shfaqur regjistrimet e veçanta klikoni mbi regjistrimin në hapësirën e punës, para butonit 🧖
- për të shfaqur regjistrimin fillestar klikoni mbi regjistrimin në hapësirën e punës, para butonit 
   në paraqitës ngarkohet regjistrimi pa redaktimet e bëra
- për të shfaqur në paraqitës regjistrimin me redaktimet e bëra klikoni butonin 🥒

### 2.2.16 Shfaqja e hapësirës së punës

Nëse klikoni butonin 😁, hapësira e punës fshihet ose shfaqet.

## 2.3 Redaktuesi i regjistrimit

Në redaktuesin e regjistrimit, i cili është pjesa qendrore e ndërfaqes për katalogim, redaktohen (shënohen dhe ndryshohen të dhënat) të dhënat në regjistrimet bibliografike dhe në ato të njësuara.

Redaktuesin e aktivizoni duke klikuar në butonin 🔍 🖍 në hapësirën e punës.

↔ COBISSCat BASH 1537955056 ✓ 🗈 🔂 🗙	2	☆ 1↓ ½
Regjistrimi i plotë	Treguesit	Përpunimi lëndor Të dhënat e koduara Linqet
1       1       100       Të dhënat e përgjithshme për përpunimin         1       1       b       d - monografi që ka dalë e plotë ose brenda një viti kalendarik         1       1       c       ✓ d - monografi që ka dalë e plotë ose brenda një viti kalendarik         1       1       e       - riprodhim i një dokumenti         1       1       f       monografi me datë botimi të dyshimtë         1       1       0       g - monografi, botimi i së cilës vazhdon më shumë se një vit         1       1       0       g - monografi, botimi i së cilës vazhdon më shumë se një vit         1       1       0       g - monografi me vit të botimit dhe vit të së drejtës së autorit         1       1       0       g - monografi me vit të shpërndarjes/botimit dhe prodhimit.         1       1       0       n - monografi me datë të saktë të botimit         1       1       0       I - distanca kohore e një koleksioni artificial         1       1       0       I - botimi ka indeks         1       1       1       1         1       1       1       1         1       1       1       1         1       1       1       1         1       1       1       1		<ul> <li>LOCAL ID=1537955056 M V03 02.02.2017 BASH::SABINAV Updated: 11.09.2017 BASH::MIRLONAB SynToCon: 20.12.2023 C3</li> <li>a00103 b2017020220170911 cBASH::SABINAV dBASH::MIRLONAB eL1008 f0 g0000007842 tC3 k20231220 wLOCAL</li> <li>an - regjistrim i ri ba - material tekst. i shtypur cm - monografi d0 - nuk ka lidhje hierarkike t2.25 - monografi të tjera dhe vepra të tjera të përfunduara 7ba - latin</li> <li>bd - monografi që ka dalë e plotë ose brenda një viti kalendarik c1981 ek - të rritur (joletrar) halb - shqipe Iba - latin</li> <li>agbr - Britania e Madhe</li> <li>agbr - Britania e Madhe</li> <li>aa - ilustrime e1 - botimi ka indeks</li> <li>alondon aBoston aHenley cRoutledge &amp; Kegan Paul d1981</li> <li>a322 f. cme il. d24 cm</li> <li>aBibliogr: f. 294-304</li> <li>alndeks: f. 305 - 322</li> <li>ahlotesise aPollo bStefanaq 700810 4070 - autor</li> <li>3451858 aPollo bStefanaq 700810 4070 - autor</li> <li>3535654 aFrasheri bKristo f1920-2016 700728 4070 - autor</li> </ul>
1     1     e     from its origins to the present day.       1     1     f     Stefanaq Pollo, Arben Puto	+ + +	992 bSabinavm2017
I     1     g     bashkëpunëtor: Kristo Frashëri       I     1     d     Titulli i saktë parafet	6	
205 Të dhënat për botimin a Botimi	+ -	

Redaktuesi i regjistrimit

Elementet në redaktues:

- 1. Akronimi i bazës së të dhënave dhe numri identifikues i regjistrimit të hapur në redaktues (linku ju dërgon në regjistrimin në COBISS+)
- 2. Butonat
  - për verifikimin e regjistrimit
  - për ruajtjen e regjistrimit
  - 🗳 për ruajtjen e modelit për regjistrimin e ri
  - **p**ër anulimin apo zbrazjen e redaktuesit
  - o 🧧 për shtimin e fushave
  - për shtimin e (nën)fushave nga kujtesa e fragmenteve
  - për shfaqjen/largimin e butonave për lëvizjen e fushave/nënfushave
  - <sup>\*</sup> për shfaqjen/largimin e butonave për shtimin/fshirjen e nënfushave
  - 🗢 për ndryshimin e maskës për shënimin e të dhënave
  - për mundësitë në redaktimin e përmbajtjes së nënfushave: vendosja e simbolit për klasifikim, vendosja e simbolit LaTeX, shndërrimi në shkronja të mëdha, shndërrimi në shkronja të vogla, shndërrimi në shkrim latin, shndërrimi në shkrim cirilik serb/maqedon, aktivizimi i numëratorit

- për shfaqjen e përshkrimit të fushave apo nënfushave të veçanta në formatin COMARC
- 3. Rreshti për përzgjedhjen e grupit për shënimin e të dhënave (regjistrimi i plotë, përshkrimi kryesor...)
- 4. Butoni me shenjat e fushave/nënfushave
- 5. Butoni dhe për zhvendosjen e fushave/nënfushave
- 6. Butoni 🛨 dhe 🔄 për shtimin/fshirjen e fushave/nënfushave
- 7. Fusha për shënimin e të dhënave me listën e hapur
- 8. Skaji për lëvizje

Tek krijimi i regjistrimit në redaktues ndodhen fushat, nënfushat dhe treguesit e paracaktuar, që paraqiten në maskën për shënimin e të dhënave. Nëpër fusha dhe nënfusha lëvizni përmes miut, tastit <Tab>, tastit <Enter> apo tasteve për lëvizje. Nëse përdorni kombinimin e tasteve <Shift> + <Tab> lëvizni për një hap prapa.

Fushat janë të shënuara me një numër me tre shifra, ndërsa nënfushat me një shkronjë ose një shifër. Katrori ngjyrë portokalli përreth shenjës së nënfushës tregon se ajo është e detyrueshme, ndërsa tri pikat mbi shenjën e fushës/nënfushës tregojnë se ajo është e përsëritshme. Disa fusha kanë edhe vlera të përcaktuara të treguesve, të cilat qëndrojnë pas shenjës së fushës.

Tek paraqitja e regjistrimeve në redaktues përdoren ngjyra të ndryshme:

- e kaltra për shenjën dhe emrin e fushave, shenjën e nënfushave dhe vlerat e treguesve
- ngjyrë të verdhë kanë fushat e zbrazëta, në të cilat ende nuk janë vendosur të dhënat përkatëse (emri i nënfushës brenda është ngjyrë hiri e hapur)
- ngjyrë të bardhë kanë fushat e plotësuara

Të dhënat vendosen ose redaktohen në nënfushat e veçanta. Duke klikuar në shenjën e fushës/nënfushës mund të bëni ndryshime në to (të shtoni, kopjoni, ndryshoni shenjën ose të fshini fushën/nënfushën). Fushat dhe nënfushat kanë një renditje të caktuar, e cila mund të ndryshohet pjesërisht (deri në atë masë që të ruhet renditja në rritje e numrave të fushave). Fushave apo nënfushave mund t'u ndryshohen vetitë e caktuara, p.sh. shkalla e detyrimit, gjatësia etj.

Nëse dëshironi që tek nënfushat e veçanta të jenë më të gjëra fushat e shënimit të të dhënave, në të cilat duket edhe

përmbajtja e teksteve të gjata, midis parametrave të përdoruesit (butoni <sup>1</sup>) duhet të klikoni kutinë e zgjedhjes tek Zgjerimi i fushave të caktuara për shënimin e të dhënave dhe shfaqja e përmbajtjes në disa rreshta .

Kërkimin në baza të ndryshme të të dhënave mund ta bëni edhe gjatë punës në redaktues duke klikuar butonin

- Reference and te kiter and the set of the se
- ♀ ✓ në hapësirën e punës apo duke shtypur tastin <F8>.

Në redaktues mund të redaktoni regjistrimin në tërësi, por mund të redaktoni edhe fushat e veçanta.

Fushat e formatit COMARC/B në regjistrimin bibliografik janë të klasifikuara në këto grupe:

- regjistrimi në tërësi të gjitha fushat
- përshkrimi kryesor fushat 2XX
- shënime 3XX, 992
- autorët 7XX, 9XX
- titujt 200, 5XX
- treguesit 0XX (por jo edhe 001)
- përpunimi lëndor 6XX, 96X
- të dhënat e koduara 1XX
- lidhjet 4XX, 856

Fushat e formatit COMARC/A në regjistrimet e njësuara janë të klasifikuara në këto grupe:

- regjistrimi në tërësi të gjitha fushat
- pikëqasjet 2XX, 4XX, 7XX
- pikëqasjet në lidhshmëri 5XX, 950
- shënimet 3XX
- shënimet e kataloguesve 820, 830, 835, 836, 911, 915, 916, 991, 992
- treguesit 010, 017, 035
- të dhënat e koduara 1XX
- burimet 801, 810, 815, 856
- klasifikimi 6XX

## 2.3.1 Shënimi i të dhënave

Të dhënat vendosen dhe ndryshohen në fushën që ndodhet pas shenjës së nënfushës. Të dhënat mund t'i shënoni, tek fushat e koduara mund t'i përzgjidhni nga listat, në bazat e njësuara i përzgjidhni nga listat e pikëqasjeve ose nga lista e rezultateve të kërkimit, kur kërkoni në nënfushat e veçanta.

Në fushën për shënimin e të dhënave mund të vendosni edhe shenjën për klasifikim NSB/NSE dhe simbolin LaTeX. Nëse është e nevojshme tekstin në fushë mund ta ndryshoni në tekst me shkronja të mëdha ose të vogla, apo të ndryshoni llojin e shkrimit (nga shkrimi latin në shkrim cirilik serb/maqedon ose anasjelltas).

Të dhënat e koduara mund t'i vendosni në disa mënyra:

- hapni listën dhe përzgjidhni kodin (përdorni miun ose tastet për lëvizje <lart>, <poshtë>)
- kodin ose vlerën e tij e shënoni në fushë; bazuar në të dhënat e shënuara në fillim, programi shfaq listën e sugjerimeve (funksioni "autocomplete")

Shënimin e të dhënave e përfundoni duke klikuar jashtë fushës ose duke shtypur tastin <Enter> apo tastin <Tab>. Përmes tastit <Enter> kaloni në fushën tjetër për shënimin e të dhënave, ndërsa përmes tastit <Tab> në shenjën tjetër të nënfushës apo fushës. Nëse shtypni tastin <Tab> dhe tastin për hapësirë, hapet dritarja për kërkim që ndodhet pranë fushës për shënimin e të dhënave (p.sh. 011a, 4641, 60X3, 7XX3), pa pasur nevojë të klikoni butonin

Përmes drejtshkrimorit mund të verifikoni saktësinë e tekstit të vendosur në fushë. Nëse në shfletuesin e internetit (*Parametrat/Gjuhët*) keni aktivizuar mundësinë e verifikimit të drejtshkrimit, gjatë shkrimit të tekstit fjalët e shënuara gabimisht nënvizohen me ngjyrë të kuqe. Në disa shfletues (p.sh. Firefox) tek çdo fushë për shënimin e të dhënave duhet të përzgjidhni mundësinë *Verifikimi i drejshkrimit* nga menuja e shkurtores, në mënyrë që fjalët e shënuara gabim të nënvizohen. Në shfletuesit Chrom dhe Microsoft Edge kjo nuk është e nevojshme. Nëse dëshironi të verifikoni fjalët e ngjashme, të cilat janë në dispozicion në fjalor, klikoni me tastin e djathtë të miut në fjalën e nënvizuar dhe nga menuja me sugjerimet përzgjidhni fjalën e duhur. Fjalët, të cilat sipash jush janë të sakta, mund t'i shtoni tek fjalori personal (klikoni në fjalë me tastin e djathtë të miut dhe përzgjidhni *Shto në fjalor*). Shih edhe kap. 5.5.

#### Shënimi i të dhënave në fushat me kontroll të njësuar

Shënimi i të dhënave në fushat me kontroll të njësuar ndryshon nga shënimi në fushat e tjera. Të dhënat në këto fusha transferohen nga baza e njësuar e të dhënave CONOR ose SGC.

Në nënfushën 3 tek fushat 60X apo 7XX shënoni pikëqasjen e njësuar dhe klikoni butonin 🔎 në skajin e djathtë të fushës.

Për lidhjen e fushave për autorët (fushat 7XX) me regjistrimet përkatëse të njësuara nga baza CONOR shërben dritarja **Kërkimi në CONOR**, ndërsa për lidhjen e fushave për emërtimet lëndore (fushat 60X) me regjistrimet përkatëse të njësuara nga baza SGC dritarja **Kërkimi në SGC**.

Elementet e dritares janë:

- rreshti i titullit
- pjesa e majtë e dritares me listën e pikëqasjeve, të cilat i përshtaten pyetjes për kërkim Kërkimi ekzekutohet në të gjithë bazën e njësuar të të dhënave dhe jo vetëm për pikëqasjet e ngjashme.
   Pikëqasjet e llojit përkatës shfaqen me ngjyrë të zezë, ndërsa pikëqasjet për entitetet e llojeve të tjera shfaqen

me ngjyrë hiri (p.sh. tek lidhja e fushës 710 me ngjyrë të zezë do të shfaqen vetëm emrat e organizatave).

- pjesa lartë në anën e djathtë të dritares, ku për pikëqasjen e përzgjedhur shfaqet regjistrimi në formatin COMARC/A
- pjesa poshtë në anën e djathtë të dritares, ku për pikëqasjen e përzgjedhur shfaqen edhe objektet në lidhshmëri Nëse ekzistojnë terma të gjerë, të ngushtë apo në lidhshmëri, ata transferohen në pjesën e majtë të dritares duke klikuar në termin e veçantë, ndërsa regjistrimi për ta lartë në pjesën e djathtë të dritares.
- fusha për shënimin e pyetjeve për kërkim

butonat

- Gjej ekzekutimi i kërkimit pas shënimit të pyetjes për kërkim
- **Prapa** kthimi në pyetjen e mëparshme për kërkim
- **Shto** shtimi i regjistrimit të njësuar të përzgjedhur në hapësirën e punës
- **Përzgjidh** konfirmimi i pikëqasjes së përzgjedhur (numri identifikues i regjistrimit të njësuar transferohet në nënfushën 3)
- Anulo anulimi i kërkimit dhe mbyllja e dritares
- LC/NAF kalimi në bazën e të dhënave LC/NAF (nuk është në dispozicion në dritaren Kërkimi në SGC)



Lidhja me regjistrimet nga baza e të dhënave CONOR

Nëpër listën e pikëqasjeve lëvizni përmes miut ose përmes tasteve për lëvizje. Pikëqasjen e përzgjedhur e transferoni në pjesën lartë në anën e djathtë të dritares duke klikuar në tastin për hapësirë, ndërsa përmes tastit <Enter> atë e konfirmoni dhe numrin e saj identifikues e transferoni në nënfushën 3 (i barasvlershëm është butoni **Përzgjidh**).

Nëse regjistrimin e njësuar nuk e gjeni në bazën CONOR, kërkimin mund ta vazhdoni në bazën e të dhënave LC/NAF. Nëse klikoni butonin **LC/NAF**, hapet dritarja për kërkim, në të cilën transferohet pyetja për kërkim e shënuar më parë. Nëse në bazën LC/NAF gjeni regjistrimin e duhur, atë e ngarkoni në hapësirën e punës dhe e shkarkoni në bazën CONOR.

## A Shënim

Regjistrimet e njësuara mund t'i shkarkojnë vetëm kataloguesit me autorizimet CAT\_NEWPN ose CAT\_NEWCB.

#### Karakteristikat e shënimit të të dhënave në fushat e formatit COMARC/A

#### Të dhënat për burimin (810)

Të dhënat për burimin, në të cilin e keni gjetur pikëqasjen e njësuar ose variantin e pikëqasjes, mund t'i transferoni në regjistrimin e njësuar nga regjistrimi në COBIB ose nga regjistrimi, të cilin aktualisht po e krijoni/redaktoni.

Në nënfushën e zbrazët 810a klikoni në butonin Që të hapet dritarja për kërkim. Nëse në dritaren për kërkim shfaqet lista e regjistrimeve, në të ndodhen regjistrimet bibliografike, që janë të ngarkuara në hapësirën e punës dhe të cilat po i krijoni/redaktoni (pranë tyre është butoni ). Nëse në listë përzgjidhni regjistrimin bibliografik të dhënat për burimin transferohen në nënfushën 810a. Lista e regjistrimeve mund të jetë e zbrazët. Në këtë rast në dritaren për kërkim shënoni pyetjen për kërkim dhe filloni kërkimin në COBIB.

#### Karakteristikat e shënimit të të dhënave në fushat e formatit COMARC/B

#### Fushat për lidhje tek burimet në vazhdim (4XX)

Fushat në bllokun 4XX, të cilat përdoren për shfaqjen e marrëdhënieve midis burimeve në vazhdim, përmbajnë nënfushën a - Titulli i saktë/kyç dhe x - ISSN, ku vendoset titulli i saktë (kyç) dhe/ose ISSN e burimit në vazhdim në lidhshmëri.

Nënfusha a duhet të shtohet vetëm kur regjistrimi për burimin në vazhdim në lidhshmëri nuk ndodhet në COBIB ose në regjistrimin ekzistues nuk ndodhet fusha 530 – *Titulli kyç*. Nënfusha a shtohet edhe kur nuk ekziston ISSN-ja.

#### Procedura

- 1. Në fushën përkatëse të bllokut 4XX në nënfushën x vendosni ISSN-në e burimit në vazhdim dhe konfirmoni shënimin e të dhënave.
- 2. Nëse regjistrimi me këtë ISSN ekziston në COBIB dhe përmban fushën 530, pas butonit shfaqet titulli kyç, që do të thotë se nënfusha a nuk është e nevojshme të plotësohet.
- 3. Nëse regjistrimi nuk përmban fushën 530 ose nëse regjistrimi nuk ekziston, klikoni butonin *Përzgjidh* në bazën e ISSN-së. Pyetja për kërkim vendoset në mënyrë automatike. Nëse klikoni në butonin **Përzgjidh** në nënfushën a vendoset titulli kyç nga rezultati i përzgjedhur nga baza ISSN.

## 2.3.2 Verifikimi i regjistrimit

Regjistrimin në redaktues mund ta verifikoni nëse përmban gabime ose mangësi të identifikuara në mënyrë

automatike (butoni ). Gabimet që i gjen programi shfaqen në pjesën e poshtme të paraqitësit. Shih edhe kap. 2.4.

# 🖓 Këshillë

Regjistrimin mund ta verifikoni edhe përmes kombinimit të tasteve <Ctrl> + <Alt> + <C>.

Gjatë ngarkimit të regjistrimit në redaktues, gabimet e mundshme shfaqen në mënyrë automatike, nëse midis

parametrave të përdoruesit (butoni ° ) keni klikuar kutinë e zgjedhjes tek *Shfaqja e gabimeve gjatë ngarkimit të* 

regjistrimit në redaktues.

## 2.3.3 Ruajtja e regjistrimit

Nëse regjistrimi nuk ka gabime të tipit "F" – Fatal, programi e ruan regjistrimin në bazën lokale të të dhënave

dhe/ose COBIB (butoni ). Me këtë rast redaktuesi zbrazet, ndërsa në skajin e poshtëm të ndërfaqes për katalogim shfaqet baza e të dhënave, në të cilën është ruajtur regjistrimi.

Gjatë ruajtjes së regjistrimit programi ju paralajmëron në gabimet e mundshme apo mospërputhjet në regjistrim.



## 2.3.4 Ruajtja si model

Nëse dëshironi që regjistrimin ta ruani si model për regjistrimin e ri bibliografik apo të njësuar, si dhe ta përdorni atë

disa herë, klikoni butonin <sup>1</sup> . Hapet dritarja **Ruaj si model**, në të cilën përcaktoni emrin e modelit. Në të njëjtën dritare modelin edhe mund ta fshini.

Nëse regjistrimin e ruani si model me emrin *DEFAULT*, të dhënat e vendosura në të mund t'i përdorni më vonë si vlera të paracaktuara. Me të njëjtin emër *DEFAULT* mund të krijoni disa modele, nëse ato janë në baza të ndryshme. Shih edhe kap. 2.3.17.5.

### 2.3.5 Anulimi

Regjistrimin në redaktues mund ta mbyllni pa e ruajtur. Kur klikoni butonin programi ju paralajmëron se regjistrimi nuk do të ruhet. Me këtë rast redaktuesi dhe paraqitësi zbrazen, ndërsa regjistrimi në hapësirën e punës mbetet i pandryshuar. Nëse bëhet fjalë për regjistrim të ri ai fshihet edhe nga hapësira e punës.

## 🗥 Shënim

Duke klikuar në butonin nuk anuloni vetëm veprimin e fundit, por të gjitha ndryshimet e bëra në regjistrim. Nëse tek parametrat e përdoruesit keni lënë të zbrazët fushën tek parametri *Shfaqja e paralajmërimit pas anulimit të redaktimit të regjistrimit*, pasi të klikoni në butonin

paralajmërimi nuk do të shfaqet.

### 2.3.6 Shtimi i fushës

Në regjistrim mund të shtoni fushën, e cila nuk shfaqet në maskën e përzgjedhur, ose fushën, të cilën dëshironi ta

përsëritni (butoni <sup>1</sup>). Në dritaren **Fusha** shënoni shenjën e fushës ose përzgjidheni atë nga lista tek "Shenja e fushës", më pas klikoni butonin **Shto**. Tek "Shenja e fushës" mund të shënoni edhe një ose disa shenja të nënfushave, të cilat dëshironi t'i shtoni në një fushë (p.sh. 3270aaa).

Fushën mund ta shtoni edhe duke klikuar në shenjën e fushës. Konfirmoni vendosjen e shenjës së fushës në mënyrë automatike ose shënoni/përzgjidhni një shenjë tjetër të fushës dhe klikoni butonin **Shto**.

### 2.3.7 Shtimi i (nën)fushës së përzgjedhur nga kujtesa e fragmenteve

Në regjistrim mund të shtoni fushat dhe nënfushat e kopjuara ose të fshira, të cilat janë të ruajtura në kujtesën e fragmenteve të fushave.

Pasi të klikoni në butonin i hapet dritarja me listën e fushave dhe nënfushave. Shenjat e fushave të kopjuara dhe të fshira janë të shënuara me shkrim bold, ndërsa shenjat e fushave, kur janë fshirë nënfushat, janë të shënuara me shkrim të zakonshëm. Në listë përzgjidhni një ose disa nënfusha që dëshironi t'i transferoni në regjistrim dhe klikoni butonin **Ngjit**. Shih edhe kap. 2.2.7.

## 🖓 Këshillë

Përmbajtjen nga kujtesa e fragmenteve mund ta përdorni disa herë, mirëpo vetëm në kuadër të një hyrjeje në COBISS Cat.

Listën e fushave dhe nënfushave të kopjuara ose të fshira mund ta hapni edhe përmes kombinimit të tasteve <Ctrl> + <Alt> + <Insert>.

### 2.3.8 Ndryshimi i maskës për shënimin e të dhënave

Në raste të veçanta, regjistrimit bibliografik që ndodhet në redaktues mund t'i ndryshoni maskën për shënimin e të

dhënave (butoni <sup>24</sup>). Është i mundur ndryshimi i maskës *M* – *monografi* në *N* – *materiale jolibra* dhe anasjelltas.

## 2.3.9 Shfaqja/fshehja e butonit për zhvendosjen e fushës/nënfushës

Fushat në regjistrim gjithmonë janë të vendosura sipas rendit ngritës të shenjave të fushave. Renditjen e tyre mund ta ndryshoni vetëm nëse keni disa përsëritje të një fushe. Brenda fushës së veçantë mund të ndryshoni renditjen e nënfushave.

Duke klikuar në butonin 🏴 para shenjës së fushave dhe nënfushave, në redaktues, shtohen butonat për

```
zhvendosjen e fushave/nënfushave lart 🚺 dhe poshtë 💷. Këta butona fshehen nëse klikoni sërish në butonin 🎌
```

# **K**ëshillë

Përmes miut mund të zhvendosni shpejt fushat ose nënfushat duke përdorur funksionin "tërhiq dhe lësho" (angl. "drag & drop").

### 2.3.10 Shfaqja/fshehja e butonit për shtimin/fshirjen e nënfushës

Tek fushat e veçanta në regjistrim mund të shtoni nënfushat e përsëritshme ose mund t'i fshini ato.

Duke klikuar në butonin <sup>\*/</sup> pas fushave për shënimin e të dhënave në nënfusha shfaqen butonat për shtimin <sup>+</sup> dhe fshirjen <sup>-</sup> e nënfushave. Këta butona fshehen nëse klikoni sërish në butonin <sup>\*/</sup>.



Shënim
Butonat për shtimin dhe fshirjen e fushave nuk mund të largohen.

#### 2.3.11 Vendosja e simbolit për klasifikim

Në fushën për shënimin e të dhënave tek nënfusha e veçantë mund të vendosni simbolin për klasifikim (klikoni

butonin dhe të përzgjidhni mundësinë **Vendos simbolin për klasifikim**). Simboli "‡" vendoset në fund të tekstit. Para simbolit "‡" në mënyrë automatike vendoset edhe hapësira, përveç rasteve kur fusha për shënimin e të dhënave është e zbrazët.

# 🖓 Këshillë

Simbolin "‡" e vendosni në fushën për shënimin e të dhënave duke shtypur tastet <AltGr> dhe <+> (tasti i parë majtas nga <Backspace> në pjesën alfanumerike të tastierës sllovene) si dhe në fund tastin për hapësirë. Vendoset simboli ",", i cili shndërrohet në "‡", kur të konfirmoni shënimin e të dhënave në nënfushë.

## 2.3.12 Vendosja e simbolit LaTeX

Në fushën për shënimin e të dhënave tek nënfushat e caktuara mund të vendosni simbolin LaTeX (klikoni butonin

dhe përzgjidhni mundësinë **Vendos simbolin LaTeX**). Simboli "<sup>a</sup>" vendoset në fund të tekstit. Para simbolit "<sup>a</sup>" në mënyrë automatike vendoset edhe hapësira, përveç në rastet kur fusha për shënimin e të dhënave është e zbrazët.

# **K**ëshillë

Simbolin "<sup>D</sup>" e vendosni në fushën për shënimin e të dhënave duke shtypur tastet <AltGr> dhe <Ž>. Vendoset simboli "<sup>D</sup>", i cili shndërrohet në "<sup>D</sup>", kur të konfirmoni të dhënat e vendosura në nënfushë.

## 2.3.13 Shndërrimi i shkronjave

Tekstin e vendosur në fushën për shënimin e të dhënave mund ta ndryshoni në tekst me shkronja kapitale ose

shkronja të vogla. Për shndërrimin e shkronjave klikoni butonin <sup>IIII</sup> dhe përzgjidhni mundësinë **Shndërro në** shkronja të mëdha ose **Shndërro në shkronja të vogla**.

#### 2.3.14 Shndërrimi i shkrimit

Shkrimin e tekstit të vendosur në fushën për shënimin e të dhënave mund ta ndryshoni (nga shkrimi latin në atë

cirilik). Për shndërrimin e shkrimit klikoni butonin e dhe përzgjidhni mundësinë **Shndërro në shkrim latin** ose **Shndërro në shkrim cirilik serb/maqedon**.

#### 2.3.15 Numëratorët

Në bazën bibliografike të të dhënave dhe në bazat e njësuara të të dhënave për nënfushat e veçanta mund të përcaktoni numëratorë. Për përcaktimin dhe redaktimin e numëratorit ju nevojitet autorizimi CAT\_EDITTYPE.

Në fushën për shënimin e të dhënave tek nënfushat e veçanta (p.sh. 020b, 021b) mund të përcaktoni numëratorin e ri ose të vendosni numrin nga numëratori ekzistues.

#### 2.3.15.1 Përcaktimi dhe redaktimi i numëratorit

Në bazë të kërkesës përcaktoni aq numëratorë, sa janë të nevojshëm për përcaktimin e numrave të veçantë.

Numëratorin e ri për nënfushën e veçantë e shtoni duke klikuar në butonin e dhe duke përzgjedhur mundësinë **Aktivizo numëratorin**. Hapet dritarja **Numëratorët**, në të cilën klikoni butonin **Redakto**. Hapet dritarja **Numëratorët në katalogim**.

Numëratorët në katalogim			×	
Regjistrimi bibliografik				^
Përzgjidhni				
Shto numëratorin e ri			~	
Emri				
Bibliografia (librat)				
Nënfusha				
020b				
Vlera tjetër				
1				
Vlera më e lartë				
9999				
Gjatësia				
4				
Parashtesa				
M <llll><mm></mm></llll>				
Shënimi				
Kushtet				
001c = m		Objekti i r	ri	Ŧ
	Në rreg	gull An	nulo	

Numëratorët në katalogim

- 1. Tek "Lloji i regjistrimit", varësisht nga nënfusha në të cilën ndodheni, në mënyrë automatike vendoset e dhëna për llojin e regjistrimit (p.sh. Regjistrimi bibliografik).
- 2. Tek "Përzgjidhni" nga lista përzgjidhni mundësinë Shto numëratorin e ri.
- 3. Tek "Emri" shënoni emrin e numëratorit.
- 4. Tek "Nënfusha" vendoset nënfusha në të cilën mund të aktivizoni numëratorin (p.sh. 020b, 021b etj.).
- 5. Tek "Vlera tjetër" vendosni numrin, i cili nga numëratori do të transferohet në nënfushë. E paracaktuar është vlera 1, të cilën mund ta ndryshoni.
- 6. Tek "Vlera më e lartë" vendosni numrin më të lartë, të cilin mund ta ketë numëratori. Nëse vlerën e paracaktuar *0* nuk e ndryshoni, vlera më e lartë nuk përcaktohet.
- 7. Tek "Gjatësia" përcaktohet gjatësia e numrit duke përfshirë edhe zerot përpara. Nëse vlerën e paracaktuar *0* nuk e ndryshoni, numri në nënfushë vendoset pa zerot përpara. Gjatësia më e madhe e lejuar e numrit është 10 shifra.
- 8. Tek "Parashtesa" mund të shënoni fjalën, e cila vendoset në nënfushë para numrit. Në fushë mund të shënoni edhe shenjat, që mundësojnë vendosjen në mënyrë automatike të datës aktuale në nënfushën e veçantë:
  - <LLLL> viti (p.sh. 2024)
  - <LL> viti (p.sh. 24 për 2024)
  - <MM> muaji
  - $\circ$  <DD> dita
- 9. Tek "Shënimi" vendoset shënimi me tekst.
- 10. Tek "Kushtet" vendosen kushtet për përzgjedhjen e numëratorit. Klikoni butonin **Objekti i ri**, tek "Nënfusha" vendosni shenjën e fushës dhe nënfushës (p.sh. 001c), ndërsa tek "Vlera" vendosni vlerën nga lista e kodeve për nënfushën e përzgjedhur. Mund të shtoni disa kushte. Kushtet mund t'i redaktoni (butoni **Redakto**) ose t'i fshini (butoni **Fshi**).

- 11. Nëse dëshironi që të mundësoni përdorimin e numëratorit, klikoni kutinë e zgjedhjes tek Aktivizimi.
- 12. Ruani të dhënat duke klikuar butonin **Në rregull**.

# Shembull

Nëse keni krijuar numëratorin, siç shihet në figurë, në regjistrimin bibliografik për monografinë, në nënfushën 020b pas parashtesës M në mënyrë automatike vendoset Viti aktual (p.sh. 2024) dhe muaji aktual (p.sh. 09) bashkë me numrin katërshifror nga numëratori (p.sh. M2024090001).

Numëratorin ekzistues mund ta ndryshoni ose plotësoni. Në dritaren **Numëratori** fillimisht përzgjidhni numëratorin dhe klikoni butonin **Redakto**. Hapet dritarja **Numëratorët në katalogim**, në të cilën të dhënat i redaktoni.

## 2.3.15.2 Shënimi i të dhënave me ndihmën e numëratorit

Në fushën për shënimin e të dhënave tek nënfusha e veçantë (p.sh. 020b, 021b) mund të vendosni numrin nga

numëratori (klikoni butonin <sup>IIII</sup> dhe përzgjidhni mundësinë **Aktivizo numëratorin**). Hapet dritarja **Numëratorët**, në të cilën përzgjidhni numëratorin (për të njëjtën nënfushë mund të përcaktoni disa numëratorë) dhe klikoni butonin **Aktivizo numëratorin**. Në fushën për shënimin e të dhënave shënohet numri nga numëratori.

# A Shënime

Numëratorët pasiv në dritaren Numëratorët kanë ngjyrë hiri të hapur.

Nëse tek numëratori i veçantë keni përcaktuar edhe kushtet, programi do ta ofroj numëratorin vetëm tek regjistrimi, i cili do të plotësoj të gjitha kushtet e kërkuara (nënfushat e caktuara dhe vlerat e tyre).

## 2.3.16 Grupet për shënimin e të dhënave

Duke klikuar në njërin nga grupet e fushave për shënimin e të dhënave në redaktues shfaqen vetëm fushat e caktuara. Nëse përzgjidhni p.sh. "Përshkrimi kryesor" tek regjistrimet bibliografike, në redaktues shfaqen vetëm fushat e bllokut 2XX. Nëse përzgjidhni "Regjistrimi i plotë", në redaktues shfaqen të gjitha fushat, të cilat janë përcaktuar për maskën e përzgjedhur.

## 2.3.17 Butonat me shenjat e fushave/nënfushave/treguesve

Shenja e fushës është një numër me tri shifra, ndërsa shenja e nënfushës është një shkronjë ose një shifër. Disa fusha kanë të përcaktuara edhe disa vlera të treguesve. Fushat mund të jenë të përsëritshme, ndërsa nënfushat edhe të detyrueshme. Se nënfusha është e detyrueshme tregon katrori ngjyrë portokalli përreth shenjës së nënfushës, ndërsa përsëritshmërinë e tregojnë tri pikat mbi shenjën e fushës/nënfushës.

## 2.3.17.1 Shtimi i fushave/nënfushave

Fushën e shtoni kur nuk ndodhet në maskën e përzgjedhur për shënimin e të dhënave ose kur atë dëshironi ta përsëritni. E njëjta gjë vlenë edhe për nënfushat.

Për shtimin e fushës klikoni në shenjën e njërës nga fushat. Hapet dritarja **Fusha**, tek "Shenja e fushës" shfaqet shenja e fushës, të cilën e keni klikuar. Nëse dëshironi të shtoni një fushë tjetër, shënoni shenjën e fushës ose fushën përzgjidheni nga lista dhe më pas klikoni **Shto**. Tek "Shenja e fushës" mund të shënoni edhe një ose disa shenja të nënfushave, të cilat dëshironi t'i shtoni në fushën e caktuar (p.sh. 3270aaa).

Në të njëjtën mënyrë mund të shtoni edhe nënfushat. Në dritaren **Nënfusha** tek "Shenja e nënfushës" mund të shënoni disa shenja të nënfushave, të cilat dëshironi t'i shtoni (p.sh. aedefgz).



## 2.3.17.2 Kopjimi i fushës

Nga regjistrimi në redaktues mund të kopjoni cilëndo fushë me nënfushat përkatëse bashkë me përmbajtje.

Klikoni shenjën e fushës që dëshironi ta kopjoni në kujtesën e fragmenteve dhe në dritaren **Fusha** klikoni butonin **Kopjo**. Fusha ruhet në kujtesën e fragmenteve të fushave.



#### 2.3.17.3 Ndryshimi i fushës/nënfushës

Nëse dëshironi që përmbajtjen e një fushe ta përdorni në një fushë tjetër, fushës mund t'ia ndryshoni shenjën (p.sh. fushën 700 dëshironi ta përdorni si fushë 701).

Klikoni në shenjën e fushës, e cila shfaqet në dritaren **Fusha** tek "Shenja e fushës". Aty shënoni apo përzgjidhni nga lista shenjën tjetër të fushës dhe klikoni butonin **Ndrysho**.

Në të njëjtën mënyrë mund të ndryshoni edhe shenjën e nënfushës.

## 2.3.17.4 Fshirja e fushës/nënfushës

Nëse dëshironi të fshini fushën, klikoni në shenjën e fushës. Në dritaren **Fusha** klikoni butonin **Fshi <shenja e fushës>**.

Në të njëjtën mënyrë mund të fshini edhe nënfushat.



Fushën mund ta fshini edhe duke klikuar në butonin 🛄. Njëjtë vlenë edhe për nënfushën tek e

```
cila fillimisht duhet të përzgjidhni mundësinë për shfaqjen e butonave për shtimin/fshirjen (butoni <sup>*/</sup>).
```

#### 2.3.17.5 Shtimi i vlerës së paracaktuar në nënfushë

Në nënfushë mund të shtoni vlerën e paracaktuar. Klikoni në shenjën e nënfushës dhe në dritaren **Nënfusha** klikoni butonin **Paracaktuar**. Në nënfushë, në mënyrë automatike, transferohet përmbajtja e nënfushës së njëjtë nga modeli me emrin *DEFAULT*.



#### 2.3.17.6 Ndryshimi i vetive të fushave/nënfushave

Disa veti të fushave dhe nënfusha në nivelin e bibliotekës mund t'i ndryshoj personi përgjegjës për katalogim, i cili ka autorizimin CAT\_EDITTYPE. Në mënyrë që ndryshimet të bëhen të vlefshme, nuk keni nevojë të mbyllni dhe të hapni aplikacionin COBISS Cat, por mjafton të freskoni faqen (tasti <F5>) apo të mbyllni dhe të hapni sërish regjistrimin, në të cilin keni ndryshuar vetitë e fushave/nënfushave.

Vetitë e fushave apo nënfushave duhet të përcaktohen për çdo maskë. Disa veti kanë të bëjnë me komplet fushën, ndërsa disa të tjera me nënfushat e veçanta.

Fushave mund t'ua ndryshoni këto veti:

- numrin e përsëritjeve të fushës brenda maskës (nëse fusha është e përsëritshme)
- vlerat e paracaktuara të treguesve (nëse treguesit janë të përcaktuar)

Vetitë e fushës	×					
Maska						
1 : M - monografi	~					
Fusha						
702 – Emër vetjak – përgjegjësi dytësore	$\sim$					
Numri i fushave 1 ~ Vlera e paracaktuar për treguesin 1						
[0] – Shfaqet në bibliografi	$\sim$					
Vlera e paracaktuar për treguesin 2						
[1] – Shënohet mbiemri dhe emri	~					
Ruaj Paracaktuar Mbyll						

Vetitë e fushës

- 1. Klikoni në shenjën e fushës dhe në dritaren **Fusha** shtypni butonin **Vetitë e fushës**. Hapet dritarja **Vetitë e fushës**.
- 2. Teka "Maska" përzgjidhni maskën për shënimin e të dhënave.
- 3. Tek "Fusha" përzgjidhni fushën, të cilës dëshironi t'i përcaktoni vetitë.
- 4. Tek "Numri i fushave" përcaktoni, se sa herë dëshironi të shfaqet fusha e përzgjedhur në maskën për shënimin e të dhënave (nëse fusha është e përsëritshme).
- 5. Vlerën e paracaktuar të treguesve (ose e të dy treguesve) mund ta ndryshoni duke përzgjedhur vlerën e re nga lista.
- 6. Të dhënat i ruani duke klikuar në butonin Ruaj.
- 7. Nëse dëshironi që parametrat e vendosur lokalë t'i fshini dhe t'i ktheni vetitë e paracaktuara të fushës, klikoni butonin **Paracaktuar**.
- 8. Dritaren e mbyllni përmes butonit **Mbyll**.

# 🗥 Shënim

Nëse në maskë nuk ka një fushë të përcaktuar, mirëpo dëshironi të përcaktoni numrin e përsëritjeve të saj, fillimisht duhet të ndryshoni shkallën e detyrimit për së paku një nga nënfushat e asaj fushe.

Nënfushave mund t'ua ndryshoni këto veti:

- shkalla e detyrimit në regjistrim
- prania e detyrueshme në regjistrim
- gjatësia më e madhe të lejuar e të dhënave të shënuara
- numri i përsëritjeve në maskën për shënimin e të dhënave
- vendosja e detyrueshme e të dhënave nga lista
- vendosja opsionale e të dhënave nga lista
- ndihma gjatë vendosjes së të dhënave nga lista

# 🗥 Shënim

Disa veti të përcaktuara në nivel global nuk mund të ndryshohen. P.sh.: për nënfushën *001c – Niveli bibliografik* nuk mund të ndryshoni as gjatësinë e as nivelin e detyrimit.

Vetitë e nënfushës	×					
Maska						
1 : M - monografi	$\sim$					
Fusha						
320 – Shënimi për bibliografitë/indekset/përmbledhjet brenda burimit	$\sim$					
Nënfusha						
a – Teksti i shënimit	$\sim$					
Shkalla e detyrimit në regjistrim						
7 – në maskë, nuk është e detyrueshme	$\sim$					
E detyrueshme në fushë						
Gjatësia						
0						
Numri i nënfushave						
1 ~						
Lista e kodeve						
Shënimi për bibliografi/indekse/përmbledhje (abstrakte) $\sim$						
Lista e kodeve - shënimi i detyrueshëm i të dhënave						
✓ Ndihma te shënimi i të dhënave						
Ruaj Paracaktuar Mbyll						



- Klikoni në shenjën e nënfushës dhe në dritaren Nënfusha klikoni butonin Vetitë e nënfushës. Hapet dritarja Vetitë e nënfushës.
- 2. Tek "Maska" përzgjidhni maskën për shënimin e të dhënave.
- 3. Tek "Fusha" përzgjidhni fushën, të cilës i përket nënfusha.
- 4. Tek "Nënfusha" përzgjidhni nënfushën, të cilës dëshironi t'ia përcaktoni vetitë.
- 5. Tek "Shkalla e detyrimit në regjistrim" vlera e shkallës së detyrimit mund të jetë 0, 1 ose 7:
  - shkalla 0 nënfusha nuk ndodhet në maskë, mirëpo atë mund ta shtoni;

- shkalla 1 – nënfusha ndodhet në maskë dhe është e detyrueshme (nëse nënfusha është e detyrueshme në nivel të sistemit, shkalla nuk mund të ndryshohet);

- shkalla 7 – nënfusha ndodhet në maskë dhe nuk është e detyrueshme.

Shkalla e detyrimit në regjistrim më së shpeshti ndryshohet tek nënfushat, të cilat dëshironi t'i përfshini ose t'i largoni nga maska e shënimit të të dhënave (p.sh. tek një nënfushë ndryshoni shkallën e detyrimit nga 0 në 7 dhe në këtë mënyrë atë e përfshini në maskë, ndërsa tek nënfusha tjetër shkallën e detyrimit 7 e ndryshoni në 0 dhe në këtë mënyrë nënfushën e largoni nga maska).

6. Tek "E detyrueshme në fushë" përcaktoni nëse nënfusha e përzgjedhur tek "Nënfusha" është e detyrueshme në fushën e përzgjedhur tek "Fusha".

- 7. Tek "Gjatësia" përcaktoni gjatësinë maksimale të të dhënave në nënfushën e përzgjedhur, nëse kjo nuk është e kufizuar në nivel të sistemit. Vlera 0 do të thotë që gjatësia nuk është e kufizuar dhe atë mund ta ndryshoni.
- 8. Tek "Numri i nënfushave" përcaktoni numrin e nënfushave të njëjta në maskë (nëse nënfusha është e përsëritshme).
- 9. Tek "Lista e kodeve" përzgjidhni listën e përcaktuar paraprakisht të kodeve, e cila vlenë për nënfushën e përzgjedhur. Në dispozicion janë të gjitha listat lokale të kodeve, si dhe disa lista globale (p.sh. lista globale e kodeve "Përcaktimi i përgjithshëm i materialit", e cila shërben për shënimin më të shpejë të të dhënave në nënfushën 200b).
- 10. Nëse klikoni kutinë e zgjedhjes tek "Shënimi i detyrueshëm i të dhënave", shënimi i të dhënave në nënfushë është i mundur vetëm nga lista, përndryshe në nënfushë mund të vendosni çdo të dhënë që dëshironi.
- 11. Nëse klikoni kutinë e zgjedhjes "Ndihma te shënimi i të dhënave", gjatë shënimit të të dhënave në nënfushë do të përzgjidhni kodin nga lista, ndërsa në nënfushë do të vendoset kuptimi i kodit në vend të kodit.
- 12. Të dhënat i ruani duke klikuar në butonin **Ruaj**.
- 13. Nëse dëshironi që parametrat lokalë, të cilët i keni vendosur vet, t'i fshini dhe t'i ktheni vetitë e paracaktuara të nënfushës, klikoni butonin **Paracaktuar**.
- 14. Dritaren e mbyllni duke klikuar në butonin **Mbyll**.

# Shembulli për përcaktimin e numrit të nënfushave

Nëse përcaktoni Vetitë e nënfushës 610a – Emërtimi lëndor në maskën M dhe tek "Numri i nënfushave" vendosni 4, kjo do të thotë se me të hyrë në maskën e përzgjedhur, në fushën 610 krijohen 4 nënfusha të zbrazëta a.

# 2.3.17.7 Ndryshimi i vlerave të treguesve

Disa fusha përmbajnë tregues, të cilët në mënyrë shtesë shpjegojnë përmbajtjen e fushës, marrëdhënien e kësaj fushe me fushat e tjera në regjistrim ose përcaktojnë mënyrën e përpunimin të të dhënave në raporte.

Fusha mund të ketë të përcaktuar më së shumti dy tregues. Për të përcaktuar apo ndryshuar vlerën e treguesit klikoni në shenjën e treguesit dhe në dritare përzgjidhni vlerën.

# 2.3.18 Zhvendosja e fushës/nënfushës

Për zhvendosjen e fushës ose nënfushës lartë klikoni butonin 💷, ndërsa për zhvendosjen poshtë klikoni butonin 💷

# 🖓 Këshillë

Fushën ose nënfushën mund ta zhvendosni edhe përmes funksionit "tërhiq dhe lësho" (angl. "drag & drop"). Në fushën/nënfushën që dëshironi ta zhvendosni klikoni me tastin e majtë të miut dhe tërhiqeni atë në vendndodhjen e re.

# 2.3.19 Shtimi/fshirja e fushës/nënfushës

Për shtimin e fushës ose nënfushës klikoni butonin +, ndërsa për fshirjen e fushës ose nënfushës klikoni butonin

Gjatë shtimit të fushës, fusha (me nënfushat e zbrazëta) në të cilën ndodheni dyfishohet, ndërsa gjatë shtimit të nënfushës shtohet nënfusha e zbrazët me shenjën e njëjtë sikurse nënfusha në të cilën ndodheni.

# 2.3.20 Manualët në formën elektronike

Gjatë punës në COBISS Cat mund të përdorni manualët e ndryshëm në formën elektronike (butoni <sup>1</sup>).

Gjatë redaktimit të regjistrimeve mund të konsultoni manualët COMARC/B dhe COMARC/A si dhe manualët e tjerë referues bazuar në sistemin e veçantë COBISS (në sistemin COBISS.SI me manualin *ZNAČKA* dhe *PREKAT*, ndërsa në sistemet e tjera COBISS edhe me manualët nga Qendra Ndërkombëtare e ISSN-së (*ISSN Manual*) dhe udhëzimet për përdorimin e aplikacionit COBISS Cat).

Contraction Contra

Manualin COMARC mund ta hapni edhe përmes tastit <F1>.

#### 2.3.21 Parametrat e përdoruesit

Tek parametrat e përdoruesit kataloguesi mund t'i bëjë të gjitha ndryshimet që i duhen. Ato janë:

- pamja e ndërfaqes për katalogim (redaktuesit mund t'i ndryshoni pozicionin)
- lëvizja me tastin <Tab> nëpër butonat 🛄, 🛄, 😐, 🖃
- shfaqja e paralajmërimit kur anuloni redaktimin e regjistrimit
- shfaqja e fushave të caktuara për shënimin e të dhënave në formë të zgjeruar dhe shfaqja e përmbajtjes në disa rreshta
- shfaqja e fushave për koleksionet e bibliotekës (fushat 996/997, 998 janë të dukshme vetëm për regjistrimet e ruajtura në kontrollues dhe në skedë të re të shfletuesit)
- freskimi i shfaqjes së regjistrimit pas ruajtjes (ndryshimet që i keni vendosur në regjistrim nuk ngjyrosen me ngjyrë të verdhë, fusha e sistemit menjëherë përditësohet)
- zgjerimi i kolonave në dritaren për kërkim (gjerësia mund të jetë e kufizuar ose jo)
- shfaqja e gabimeve të mundshme gjatë ngarkimit të regjistrimit në redaktues

Klikoni butonin i cili është afër butonit për mbylljen e ndërfaqes, dhe në dritaren **Parametrat e përdoruesit** përzgjidhni apo zbrazni kutinë e zgjedhjes tek parametrat, të cilët dëshironi t'i ndryshoni. Në mënyrë që ndryshimi të jetë i vlefshëm duhet të klikoni butonin **Ruaj** dhe të freskoni apo të ngarkoni sërish faqen elektronike (tasti <F5>).

# \land Paralajmërime

Përmes tastit <F5> ngarkoni sërish aplikacionin COBISS Cat, me çrast redaktuesi zbrazet.

Parametri *Shfaqja e paralajmërimit pas anulimit të redaktimit të regjistrimit* shfaqet në dritaren **Parametrat e përdoruesit** vetëm kur për herë të parë anuloni redaktimin e regjistrimit pa e

ruajtur atë (butoni 🎽 ).

#### 2.3.22 Lidhja me COBISS Lib

Duke klikuar në butonin 🗣 në mënyrë direkte kaloni në aplikacionin COBISS Lib, ku mund të vazhdoni me shtimin e fushave 996/997, 998 dhe procedurave të tjera.

# 2.4 Paraqitësi i regjistrimit

Paraqitësi i regjistrimit është pjesa e djathtë e ndërfaqes për katalogim, në të cilën shfaqet regjistrimi nga redaktuesi ose regjistrimi nga hapësira e punës. Në paraqitës nuk shfaqen fushat për koleksionet e bibliotekës.

Pjesa e poshtme e paraqitësit shërben për shfaqjen e njoftimeve automatike të programit.

🖊 CO	BIB ID=1554235104 M V01 03.12.2012 KNTAL::COSERVISAL_OCLC Conversion: 03.12.2012 C3
000	a00101 b201212030000000 cKNTAL::COSERVISAL_OCLC d e  f0 g0000071227 tC3
	u20121203 vOCLC wCOBIB
001	an – regjistrim i ri ba – material tekst, i shtypur cm – monografi d0 – nuk ka lidhje hierarkike
	eocm53982183 7ba – <i>latin</i>
010	a9992716304 d\$16.00
010	a9789992716304
100	bd – monografi që ka dalë e plotë ose brenda një viti kalendarik c2002 ea – fëmijë në përgjithësi
	halb – shqipe Iba – latin
1010	aalb - shqipe aita - italiane aang - angleze e vjetër (rreth 600-1100) ager - gjermane afre -
	franceze
102	aalb – Shqipëria
105	aa – ilustrime be – fjalor
2000	aFjalor shumëgjuhësh për fëmijë ete ilustrime fHasan ţCipuri g[ilustrimet, Kosta Raka]
210	a Tiranë cBotimet Toena d2002
215	a140 f. cil. d20 x 25 cm
300	aAlbanian, Italian, English, German, French.
606 1	aAlbanian language wDictionaries, Juvenile xItalian 2LC – Emërtime lëndore të Bibliotekës së Kongresit
606 1	aAlbanian language wDictionaries, Juvenile xEnglish 2LC – Emërtime lëndore të Bibliotekës së Kongresit
606 1	aAlbanian language wDictionaries, Juvenile xGerman 2LC – Emërtime lëndore të Bibliotekës së Kongresit
606 1	aAlbanian language wDictionaries, Juvenile xFrench 2LC – Emërtime lëndore të Bibliotekës së Kongresit
606 1	aPicture dictionaries, Albanian 2LC – Emërtime lëndore të Bibliotekës së Kongresit
700 1	aţCipuri bHasan
Parala	imërimet:
675c: N	Vënfusha c është e detvrueshme.
010a: I	SBN e gabuar.
7004: 1	Mungon kodi për llojin e autorësisë (70X4).
101a: \	/erifikoni kodin për gjuhën!

#### Paraqitësi i regjistrimit

Nëse në paraqitës ndodhet regjistrimi që po redaktohet (ikona që e përcakton atë është lapsi në fillim të fushës së sistemit), të gjitha të dhënat që shtohen ose ndryshohen kanë ngjyrë të verdhë. Të dhënave për autorin u shtohen edhe variantet e emrave nga bazat e njësuara të të dhënave (ato i paraqet simboli "<"). Nëse regjistrimin e verifikoni apo e ruani, këto variante të emrave shfaqen në bllokun 90X.

Nëse midis parametrave të përdoruesit (butoni <sup>1</sup>) klikoni kutinë e zgjedhjes *Freskimi i paraqitjes pas ruajtjes së regjistrimit*, regjistrimi në paraqitës freskohet menjëherë pas ruajtjes, ndërsa ndryshimet e bëra në regjistrim nuk ngjyrosen me të verdhë.

Numrat e fushave dhe përmbajtja e nënfushave kanë ngjyrë të zezë, vlerat e treguesve kanë ngjyrë të kaltër, ndërsa shenjat e nënfushave kanë ngjyrë portokalli. Linqet aktive të faqeve elektronike kanë ngjyrë të kaltër.

Në paraqitës mund të shikoni cilindo regjistrim nga hapësira e punës ose regjistrimin që ndodhet në redaktues. Regjistrimet i zëvendësoni me njëri-tjetrin duke klikuar në butonin e duhur në hapësirën e punës:

- regjistrimet e veçanta i shfaqni në paraqitës duke klikuar mbi regjistrimin në hapësirën e punës, para butonit
- regjistrmin fillestar e shfaqni në paraqitës duke klikuar mbi regjistrimin në hapësirën e punës, para butonit
   në paraqitës ngarkohet varianti i regjistrimit para redaktimit
- regjistrimin që po redaktoni e shfaqni sërish në paraqitës duke klikuar në butonin 🥒 në paraqitës ngarkohet regjistrimi me redaktimet e bëra

Nga nënfushat e regjistrimit në paraqitës mund të kopjoni tekstin. Këtu përdoren komandat e përgjithshme për kopjim. Tekstin e caktuar mund ta gjeni duke kombinuar tastet <Ctrl> + <F>.

# 🖌 Këshillë

25 tekstet e fundit të kopjuara ose të prera mund t'i përdorni përsëri dhe t'i ngjisni në një fushë tjetër për shënimin e të dhënave. Përmes tasteve <Windows> + <V> fillimisht aktivizoni mundësinë e qasjes në historinë e kujtesës së fragmenteve (angl. "clipboard history)", më pas nga lista përzgjidhni tekstin që ju nevojitet.

Gjatë verifikimit të saktësisë së regjistrimit ose ruajtjes së regjistrimit që ndodhet në redaktues, ekzekutohen kontrollet programore. Programi ju paralajmëron në gabime ose mangësi duke nënvizuar me ngjyrë të kuqe skajin e poshtëm të ndërfaqes për katalogim. Gabimet shfaqen në pjesën e poshtme të paraqitësit. Fillimisht shfaqet shenja e fushës dhe nënfushës, më pas përshkrimi i gabimit apo mangësisë. Duke klikuar në shenjën e fushës dhe nënfushës, kaloni në fushën që ka nevojë për përmirësime apo plotësime.

Nëse midis parametrave të përdoruesit (butoni ) klikoni kutinë e zgjedhjes tek *Shfaqja e gabimeve gjatë ngarkimit të regjistrimit në redaktues*, menjëherë pas ngarkimit të regjistrimit në redaktues shfaqen gabimet e mundshme.

Për paralajmërime përdoren ngjyra të ndryshme:

- ngjyra e kuqe për gabime të padiskutueshme Paralajmërimet e tipit "F" – Fatal, përmirësimi i gabimeve është i detyrueshëm; regjistrimi qëndron në redaktues.
- ngjyra vjollcë për mospërputhje
   Paralajmërimet e tipit "W" Warning, përmirësimi i gabimeve nuk është i detyrueshëm; për ta redaktuar regjistrimin, duhet ta ngarkoni përsëri në redaktues.
- ngjyra e zezë për mangësitë e mundshme
   Paralajmërimet e tipit "I" Info, përmirësimi i gabimeve nuk është i detyrueshëm; për ta redaktuar regjistrimin, duhet ta ngarkoni përsëri në redaktues.

Nëse regjistrimi është pa gabime, skaji i poshtëm i ndërfaqes për katalogim ngjyroset në të gjelbërt.

# 3 Procedurat bazë të punës me regjistrimet

Pavarësisht ndryshimit të ndërfaqes për katalogim, procesi i katalogimit të përbashkët mbetet i njëjtë. Gjatë punës me regjistrimet ju ndihmon manuali COBISS3/Katalogimi, kap 8.

Procedurat bazë janë:

- kërkimi i regjistrimeve në baza të ndryshme
- krijimi i regjistrimit
  - nga fillimi (butoni **Regjistrimi i ri** në dritaren për kërkim ose butoni regjistrimi nuk ndodhet as në bazën lokale e as në COBIB, si dhe nuk mund të shkarkohet nga asnjë bazë e huaj e të dhënave
  - duke përftuar një regjistrim të ri (butoni en hapësirën e punës), nëse në bazën lokale, në COBIB ose në COBISS.net gjeni një regjistrim, i cili është i ngjashëm me regjistrimin që dëshironi ta krijoni
  - përmes modelit për regjistrimin e ri (butoni <sup>1</sup> në redaktuesin e regjistrimit), nëse katalogoni një numër më të madh të burimeve bibliografike, tek të cilat shumica e të dhënave janë të njëjta
- redaktimi i regjistrimit (butoni **Redakto** në dritaren për kërkim ose butoni 🌌 në hapësirën e punës)
  - redaktimi i regjistrimit që ekziston në bazën lokale të të dhënave dhe në COBIB
  - redaktimi i regjistrimit direkt në COBIB
  - redaktimi i regjistrimeve lokale, të cilat janë krijuat përmes konvertimit, sepse biblioteka para se të bëhet pjesë e sistemit COBISS ka përdorur një sistem tjetër
- shkarkimi i regjistrimit
  - nga baza COBIB dhe COBISS.net (butoni **Redakto** në dritaren për kërkim ose butoni *n*ë hapësirën e punës), nëse regjistrimi nuk ndodhet në bazën lokale, mirëpo ekziston në COBIB ose COBISS.net
  - nga bazat e huaja të të dhënave: Katalogu LC, WorldCat, ISSN, LC/NAF (butoni në hapësirën e punës), nëse regjistrimi nuk ndodhet as në bazën lokale e as në COBIB, mirëpo ekziston në njërën nga bazat e huaja të të dhënave

# 4 Lista e shkurtoreve (tasteve të shpejta) për aplikimin e disa procedurave

Shkurtoret në tastierë janë tastet ose kombinimet e tasteve; me përdorimin e tyre kryhen më shpejt procedurat, të cilat zakonisht ekzekutohen përmes miut.

Tastet e shpejta (angl. keyboard shortcuts) mund t'i përdorni në pjesë të ndryshme të ndërfaqes së përdoruesit të aplikacionit COBISS Cat.

SHKURTORJA (TASTET E SHPEJTA)	PROCEDURA
<altgr> + &lt;Ž&gt;</altgr>	vendosja e shenjës LaTeX (pas vendosjes së të dhënave në nënfushë)
<altgr> + &lt;+&gt; + tasti për hapësirë</altgr>	vendosja e shenjës për klasifikim (pas vendosjes së të dhënave në nënfushë)
<ctrl> + <alt> + <c></c></alt></ctrl>	verifikimi i regjistrimit; e barasvlershme me butonin 💙
<ctrl> + <alt> + <d></d></alt></ctrl>	shtimi i vlerës së paracaktuar në nënfushë; e barasvlershme me butonin <b>Paracaktuar</b>
<ctrl> + <alt> + <s></s></alt></ctrl>	ruajtja e regjistrimit; e barasvlershme me butonin 🕒
<ctrl> + <alt> + &lt;+&gt;</alt></ctrl>	krijimi i regjistrimit; e barasvlershme me butonin
<ctrl> + <alt> + <insert></insert></alt></ctrl>	hapja e listës së fushave dhe nënfushave të kopjuara/të fshira; e barasvlershme me butonin
<ctrl> + kliko në rreshtin me rezultatin</ctrl>	përzgjedhja e regjistrimit të parë në rezultatet e kërkimit (duhet të keni kujdes që të mos klikoni në kutinë e zgjedhjes tek numri rendor)
<ctrl> + <shift> + kliko në rreshtin me rezultatin</shift></ctrl>	përzgjedhja e regjistrimit të fundit në rezultatet e kërkimit
<f1></f1>	hapja e manualit COMARC
<f8></f8>	kalimi nga dritarja për kërkim në redaktues dhe anasjelltas; e barasvlershme me butonin 🔍 🖍

SHKURTORJA (TASTET E PËRGJITHSHME)	PROCEDURA
<f5></f5>	freskimi i faqes
<enter></enter>	lëvizja nëpër nënfushat (e fushave për shënimin e të dhënave) në redaktues, aktivizimi i disa butonave, përzgjedhja e kodeve dhe pikëqasjeve nga lista
<tab></tab>	lëvizja nëpër elementet e ndërfaqes; në redaktues lëvizni nëpër shenjat e fushave dhe nënfushave, fushat për shënimin e të dhënave dhe butonat për kërkim
<shift> + <tab></tab></shift>	kthimi nëpër elementet e ndërfaqes
tasti për hapësirë	aktivizimi i butonave, përzgjedhja e pikëqasjeve nga lista
tastet për lëvizje <lart>, <poshtë></poshtë></lart>	hapja e menuve në formë liste dhe lëvizja nëpër to, lëvizja nëpër listën e pikëqasjeve

SHKURTORJA (TASTET E PËRGJITHSHME)	PROCEDURA
tastet për lëvizje <majtas>, <djathtas></djathtas></majtas>	lëvizja nëpër butonat majtas, djathtas; lëvizja nga shenja e fushës në përzgjedhjen e treguesit
<page up="">, <page down=""></page></page>	kalimi në faqen e mëparshme ose në faqen tjetër të pjesës aktive të dritares
<ctrl> + rrota e miut</ctrl>	"zoom in/out"
<windows> + <v></v></windows>	hapja e historisë së kujtesës së fragmenteve

Numri i shkurtoreve të përgjithshme të sistemit operativ Windows dhe shkurtoreve të shfletuesit të internetit është shumë më i madh.

# 5 Simbolet, drejtshkrimi dhe mundësitë e tjera

Gjatë punës në COBISS Cat, sistemi operativ dhe shfletuesi i internetit ju ofron mundësi për vendosje më të lehtë të simboleve dhe për aktivizim të drejtshkrimorit.

# 5.1 Vendosja e simboleve me ndihmën e tastierës

Për vendosje të saktë të të dhënave ju nevojitet tastierë standarde dhe përcaktim i saktë i tastierës për gjuhën e caktuar në sistemin Windows. Në këtë mënyrë mund t'i vendosni të gjitha shkronjat e gjuhës së caktuar, simbolet e tjera nga tastiera dhe simbolet që përfitohen nga kombinimi i simboleve me shkronjat bazë (p.sh. <AltGr> + < > + <A> përfitohet Ä).

# 5.2 Tabelat e simboleve

Për vendosjen e simboleve nga UNICODE ju ndihmojnë tabelat e ndryshme të simboleve. Tabela e simboleve (Character Map) ndodhet në sistemin Windows dhe mundëson shfaqjen e simboleve që janë në dispozicion për shkrimin e përzgjedhur.

Në fushën për kërkim në shiritin e detyrave Windows shënoni *Tabela e simboleve (Character Map)* dhe hapeni atë. Simbolet janë të grumbulluara bazuar në llojin e shkrimit. Shkrimi i paracaktuar është Arial, ndërsa me ndryshimin e shkrimit ndryshohen edhe simbolet. Nëse përzgjidhni mundësinë *Paraqitja shtesë (Advanced view)*, mund të kërkoni edhe me emrin e simbolit. Në listë gjeni simbolin e duhur, përzgjidheni dhe vendoseni në fushën për shënimin e të dhënave në dritaren për kërkim ose tek nënfusha e veçantë.



Tabela e simboleve

Mund të përdorni edhe tabelën e simboleve (BabelMap), të cilën e transferoni nga faqja e internetit: https://www.babelstone.co.uk/Software/BabelMap.html. Përparësia e këtyre tabelave është se në fushën për shënimin e të dhënave mund të shënoni edhe tekstin, jo vetëm shkronjat e veçanta. Nga tabela e simboleve në kujtesën e fragmenteve mund të kopjoni simbolet e veçanta ose tekste të plota, të cilat i keni shënuar në fushën për shënimin e të dhënave tek *Edit Buffer*, dhe ato më pas i ngjitni në aplikacionin COBISS Cat.

U BabelMa	р															_		×
File Edit Find Tools Fonts Options Bookmarks View Help																		
BMP SN	NP S	SIP	TIP	SSP	PUA	A	А-В											
	Basic N	Aultilingu	ual Plane	e : Latin	-1 Supp	lement	[00800	00FF] (1	28 char	acters)		_		_	_	_		
	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	A	В	C		E	F		
0090	?	?	?	?	?	?	?	?	?	?	?	?	?	?	?	?		
00A0		i	¢	£	¤	¥		§		©	<u>a</u>	<b>«</b>	-	-	®	-		<u>&gt;&gt;&gt;</u>
00B0	0	±	2	3	′	μ	ſ	•		1	Q	<b>»</b>	1⁄4	1⁄2	3⁄4	i		<<
00C0	À	Á	Â	Ã	Ä	Å	Æ	Ç	È	É	Ê	Ë	Ì	Í	Î	Ï		<u>&gt;&gt;</u>
00D0	Ð	Ñ	Ò	Ó	Ô	Õ	Ö	×	Ø	Ù	Ú	Û	Ü	Ý	Þ	ß		
00E0	à	á	â	ã	ä	å	æ	ç	è	é	ê	ë	ì	í	î	ï		<=
00F0	ð	ñ	ò	ó	ô	õ	Ö	÷	ø	ù	ú	û	ü	ý	þ	ÿ		=>
0100	Ā	ā	Ă	ă	Ą	ą	Ć	ć	Ĉ	ĉ	Ċ	ċ	Č	č	Ď	ď	<b>•</b>	VS
	U+00F	1 LATIN	N SMAL	L LETT	ERNW	VITH TI	LDE								Decima	l 241	_	?
- Select Unic	ode Blo	ock —					Search	for Cha	aracter b	y Name	•					-Go t	o Code	Point
Latin-1 Supplement Vords Search Select \$0000 Go																		
Composite Font Configure     C Single Font Cambria     √     12																		
Edit Buffer																		
El Niñ																		
C Gherb A	lada (i	Tent	Mada		~													×
Glyph Mode (* Text Mode (* Cojor     Character C NCR (hex) C NCR (dec) C HTML C UCN     Hide Save Clear Copy Cut																		

Tabela e simboleve (BabelMap)

Për gjetjen e shkronjave për gjuhët e veçanta ju ndihmon aplikacioni Unicodia

(https://www.majorgeeks.com/files/details/unicodia.html). Përmes tabelës së simboleve në kujtesën e fragmenteve mund kopjoni vetëm simbolet e veçanta.



Tabela e simboleve (Unicodia)

# 5.3 Shtimi i gjuhës dhe ndryshimi i konfigurimit të tastierës

Sistemi Windows ofron shumë pako gjuhësore, që mundësojnë shfaqjen e ndërfaqes së përdoruesit në gjuhën që ju dëshironi.

Mund të ndryshoni renditjen e simboleve në tastierë për gjuhën tjetër, pa pasur nevojë të ndryshoni gjuhën e ndërfaqes së përdoruesit. Kjo është praktike në rastet kur kohë pas kohe vendosni tekste në ndonjë gjuhë ose shkrim tjetër.

Në fushën për kërkim tek shiriti i detyrave Windows shënoni *Parametrat (Settings)*, përzgjidhni *Ora dhe gjuha (Time & language)*, më pas *Gjuha (Language)*. Tek *Gjuhët e preferuara (Preferred languages)* klikoni *Shto gjuhën (Add a language)* dhe nga lista përzgjidhni gjuhën. Klikoni *Përpara (Next)* dhe largoni tikun tek *Pakoja gjuhësore (Install language pack)*, nëse këtë gjuhë do ta përdorni vetëm për tastierë. Pasi të klikoni në butonin **Instalo (Install)**, gjuha e përzgjedhur shtohet në shiritin e detyrave.



Midis gjuhëve mund të lëvizni duke kombinuar tastet <Windows> + <tasti për hapësirë>. Me këtë rast renditja e simboleve në tastierë ndryshon.



Rregullimi i gjuhës

# 5.4 Shtimi i tastierës në ekran

Kur tastierën e rregulloni për një gjuhë të huaj dhe nuk e njihni renditjen e simboleve, mund ta përdorni tastierën në ekran. Windows ofron dy tastiera në ekran.

Të parën, që është më e thjeshtë, e aktivizoni duke klikuar me tastin e djathtë të miut në shiritin e detyrave Windows dhe nga menuja përzgjidhni *Shfaq butonin e tastierës në ekran (Show touch keyboard button)*. Butoni i tastierës në ekran shfaqet në anën e djathtë të shiritit të detyrave. Nëse ndryshoni gjuhën (<Windows> + <tasti për hapësirë>) ndryshon edhe gjuha e tastierës.

Nëse në tastierën në ekran shtypni butonin e majtë të miut mbi shkronjën e caktuar dhe e mbani të shtypur, përveç shkronjës së caktuar shfaqen edhe shkronjat me shenja të ndryshme diakritike.

	Ĵ	е	3	é	ê	ë	è					×
q	2 W	е	r	t	у	u	i	9 O	°p	å	<	×
а	s	d	f	g	h	j	k	: 1	ø	æ		↩
$\uparrow$	z	x	с	v	b	n	m	,		?	i	Ŷ
&123	Ctrl	$\odot$								<	>	SME

Tastiera në ekran për gjuhën norvegjeze

Nëse dëshironi të aktivizoni tastierën tjetër më të avancuar, në fushën për kërkim në shiritin e detyrave Windows

shënoni *Parametrat (Settings)*, përzgjidhni *Qasja (Ease of access)* dhe në pjesën e majtë të dritares klikoni *Tastiera (Keyboard)*. Në pjesën e djathtë të dritares aktivizoni *Përdor tastierën në ekran (Use the on-screen keyboard)*. Edhe kësaj tastiere mund t'ia ndryshoni gjuhën përmes kombinimit të tasteve <Windows> + <tasti për hapësirë>. Nëse planifikoni ta përdorni shpesh, ikonën e saj mund ta shtoni në shiritin e detyrave.



Parametrat e tastierës në ekran

Në shfletuesin e internetit Chrome mund të përdorni edhe tastierën në ekran, të cilën e mundëson Google Tools për shënimin e tekstit (https://www.google.com/intl/sl/inputtools/chrome/index.html). Fillimisht duhet të instaloni *Google Imput Tools for Multi-languages: The Chrome Extensions*. Përparësia e kësaj mënyre është mundësia e përdorimit të kombinuar të tastierës në ekran dhe asaj fizike gjatë shënimit të të dhënave. Në këtë rast tastiera fizike merr klasifikim të njëjtë të tasteve sikurse tastiera në ekran. Udhëzimet për instalimin dhe përdorimin e tastierës i gjeni online, p.sh. https://www.youtube.com/watch?v=-rSGDSHvSXI.

Disa shkronja të huaja mund t'i shënoni duke kombinuar tastet. Në figurat e paraqitura është tastiera sllovene, ndërsa në tabelën nën figura janë paraqitur shkurtoret për simbolet që mund t'i vendosni përmes tastierës.

Slovenščina	<b>v</b> ×
<u>, 1 2 3 4 5 6 7 8 9 0 ' +</u>	$\propto$
qwertzuiopšđ	Ž
a s d f g h j k l č ć	
	Ŷ
Ctrl + Alt Ctrl	+ Alt

Renditja e simboleve në tastierën në ekran



Renditja e simboleve në tastierën në ekran përmes përdorimit të tasteve <Ctrl>+<Alt>

SIM	<b>IBOLI</b>	SHËNIMI I TË DHËNAVE ME TASTIERË SLLOVENE	PËRSHKRIMI I SIMBOLIT	GJUHA
Â	â	<ctrl>+<alt>+&lt;3&gt;+<a> <ctrl>+<alt>+&lt;3&gt;+<a></a></alt></ctrl></a></alt></ctrl>	<i>a</i> me theks lakor (cirkumfleks)	franceze, friuliane, norvegjeze, portugeze, romune
Ă	ă	<ctrl>+<alt>+&lt;4&gt;+<a> <ctrl>+<alt>+&lt;4&gt;+<a></a></alt></ctrl></a></alt></ctrl>	<i>a</i> me theks lakor (brevis)	romune
Á	á	<ctrl>+<alt>+&lt;9&gt;+<a> <ctrl>+<alt>+&lt;9&gt;+<a></a></alt></ctrl></a></alt></ctrl>	<i>a</i> me theks të mprehtë (akut)	çeke, islandeze, hungareze, portugeze, sllovake, spanjolle
Ä	ä	<ctrl>+<alt>+&lt;'&gt;+<a> <ctrl>+<alt>+&lt;'&gt;+<a></a></alt></ctrl></a></alt></ctrl>	<i>a</i> me dy pika (dierezë)	estoneze, finlandeze, gjermane, sllovake, suedeze
Ą	ą	<ctrl>+<alt>+&lt;6&gt;+<a> <ctrl>+<alt>+&lt;6&gt;+<a></a></alt></ctrl></a></alt></ctrl>	<i>a</i> me shenjën 'v' poshtë, të kthyer në të djathtë (a hundore)	lituaneze, polake
Ç	Ç	<ctrl>+<alt>+&lt;+&gt;+<c> <ctrl>+<alt>+&lt;+&gt;+<c></c></alt></ctrl></c></alt></ctrl>	<i>c</i> me bisht, të kthyer në të majtë	shqipe, franceze, friuliane, portugeze, turke
Ď	ď	<ctrl>+<alt>+&lt;2&gt;+<d> <ctrl>+<alt>+&lt;2&gt;+<d></d></alt></ctrl></d></alt></ctrl>	<i>d</i> me theks lakor (karon)	çeke, sllovake
Ě	ě	<ctrl>+<alt>+&lt;2&gt;+<e> <ctrl>+<alt>+&lt;2&gt;+<e></e></alt></ctrl></e></alt></ctrl>	<i>e</i> me theks lakor (karon)	çeke, serbe lusatiane
É	é	<ctrl>+<alt>+&lt;9&gt;+<e> <ctrl>+<alt>+&lt;9&gt;+<e></e></alt></ctrl></e></alt></ctrl>	<i>e</i> me theks të mprehtë (akut)	çeke, franceze, islandeze, italiane, hungareze, norvegjeze, portugeze, sllovake, spanjolle
Ë	ë	<ctrl>+<alt>+&lt;`&gt;+<e> <ctrl>+<alt>+&lt;`&gt;+<e></e></alt></ctrl></e></alt></ctrl>	<i>e</i> me dy pika (dierezë)	shqipe, franceze
Ę	ę	<ctrl>+<alt>+&lt;6&gt;+<e> <ctrl>+<alt>+&lt;6&gt;+<e></e></alt></ctrl></e></alt></ctrl>	<i>e</i> me bisht poshtë, të kthyer në të djathtë (e hundore)	lituaneze, polake
Î	î	<ctrl>+<alt>+&lt;3&gt;+<i> <ctrl>+<alt>+&lt;3&gt;+<i></i></alt></ctrl></i></alt></ctrl>	<i>i</i> me theks lakor (cirkumfleks)	franceze, friuliane, italiane, romune
Í	í	<ctrl>+<alt>+&lt;9&gt;+<i> <ctrl>+<alt>+&lt;9&gt;+<i></i></alt></ctrl></i></alt></ctrl>	<i>i</i> me theks të rëndë (akut)	çeke, islandeze, hungareze, portugeze, sllovake, spanjolle
Ľ	ľ	<ctrl>+<alt>+&lt;2&gt;+<l> <ctrl>+<alt>+&lt;2&gt;+<l></l></alt></ctrl></l></alt></ctrl>	<i>l</i> me theks lakor (karon)	sllovake
Ĺ	ĺ	<ctrl>+<alt>+&lt;9&gt;+<l> <ctrl>+<alt>+&lt;9&gt;+<l></l></alt></ctrl></l></alt></ctrl>	<i>l</i> me theks të mprehtë (akut)	sllovake
Ł	ł	<ctrl>+<alt>+<l> <ctrl>+ <alt>+<k></k></alt></ctrl></l></alt></ctrl>	<i>l</i> me vizë (l e fortë)	serbe lusatiane, polake
Ň	ň	<ctrl>+<alt>+&lt;2&gt;+<n> <ctrl>+<alt>+&lt;2&gt;+<n></n></alt></ctrl></n></alt></ctrl>	<i>n</i> me theks lakor (karon)	çeke, sllovake
Ń	ń	<ctrl>+<alt>+&lt;9&gt;+<n> <ctrl>+<alt>+&lt;9&gt;+<n></n></alt></ctrl></n></alt></ctrl>	<i>n</i> me theks të mprehtë (akut)	serbe lusatiane, polake

SIMBOLI		SHËNIMI I TË DHËNAVE ME TASTIERË SLLOVENE	PËRSHKRIMI I SIMBOLIT	GJUHA	
Ô	ô	<ctrl>+<alt>+&lt;3&gt;+<o> <ctrl>+<alt>+&lt;3&gt;+<o></o></alt></ctrl></o></alt></ctrl>	o me theks lakor (cirkumfleks)	franceze, friuliane, norvegjeze, portugeze, sllovake	
Ó	ó	<ctrl>+<alt>+&lt;9&gt;+<o> <ctrl>+<alt>+&lt;9&gt;+<o></o></alt></ctrl></o></alt></ctrl>	o me theks të mprehtë (akut)	çeke, serbe lusatiane e sipërme, islandeze, italiane, hungareze, norvegjeze, polake, portugeze, sllovake, spanjolle	
Ö	Ö	<ctrl>+<alt>+&lt;'&gt;+<o> <ctrl>+<alt>+&lt;'&gt;+<o></o></alt></ctrl></o></alt></ctrl>	o me dy pika (dierezë)	estoneze, finlandeze, islandeze, hungareze, gjermane, suedeze, turke	
Ő	ő	<ctrl>+<alt>+&lt;0&gt;+<o> <ctrl>+<alt>+&lt;0&gt;+<o></o></alt></ctrl></o></alt></ctrl>	<i>o</i> me theks të mprehtë dysh (akut)	hungareze	
Ř	ř	<ctrl>+<alt>+&lt;2&gt;+<r> <ctrl>+<alt>+&lt;2&gt;+<r></r></alt></ctrl></r></alt></ctrl>	<i>r</i> me theks lakor (karon)	çeke, serbe lusatiane e sipërme	
Ŕ	ŕ	<ctrl>+<alt>+&lt;9&gt;+<r> <ctrl>+<alt>+&lt;9&gt;+<r></r></alt></ctrl></r></alt></ctrl>	<i>r</i> me theks të mprehtë (akut)	serbe lusatiane e poshtme, sllovake	
Ś	ś	<ctrl>+<alt>+&lt;9&gt;+<s> <ctrl>+<alt>+&lt;9&gt;+<s></s></alt></ctrl></s></alt></ctrl>	s me theks të mprehtë (akut)	serbe lusatiane e poshtme, polake	
Ş	ş	<ctrl>+<alt>+&lt;+&gt;+<s> <ctrl>+<alt>+&lt;+&gt;+<s></s></alt></ctrl></s></alt></ctrl>	s me bisht, të kthyer në të majtë	romune, turke	
Ť	ť	<ctrl>+<alt>+&lt;2&gt;+<t> <ctrl>+<alt>+&lt;2&gt;+<t></t></alt></ctrl></t></alt></ctrl>	<i>t</i> me theks lakor (karon)	çeke, sllovake	
Ţ	ţ	<alt>+&lt;0222&gt; <alt>+ &lt;0254&gt; (tastiera me numra)</alt></alt>	<i>t</i> me bisht, të kthyer në të majtë	romune	
Ú	ú	<ctrl>+<alt>+&lt;9&gt;+<u> <ctrl>+<alt>+&lt;9&gt;+<u></u></alt></ctrl></u></alt></ctrl>	<i>u</i> me theks të mprehtë (akut)	çeke, islandeze, hungareze, portugeze, sllovake, spanjolle	
Ü	ü	<ctrl>+<alt>+&lt;'&gt;+<u> <ctrl>+<alt>+&lt;'&gt;+<u></u></alt></ctrl></u></alt></ctrl>	<i>u</i> me dy pika (dierezë)	estoneze, franceze, hungareze, gjermane, spanjolle, turke	
Ů	ů	<ctrl>+<alt>+&lt;5&gt;+<u> <ctrl>+<alt>+&lt;5&gt;+<u></u></alt></ctrl></u></alt></ctrl>	<i>u</i> me unazë lart	çeke	
Ű	ű	<ctrl>+<alt>+&lt;0&gt;+<u> <ctrl>+<alt>+&lt;0&gt;+<u></u></alt></ctrl></u></alt></ctrl>	<i>u</i> me theks të mprehtë dysh (akut)	hungareze	
Ý	ý	<ctrl>+<alt>+&lt;9&gt;+<y> <ctrl>+<alt>+&lt;9&gt;+<y></y></alt></ctrl></y></alt></ctrl>	<i>y</i> me theks të mprehtë (akut)	çeke, islandeze, sllovake	
Ź	ź	<ctrl>+<alt>+&lt;9&gt;+<z> <ctrl>+<alt>+&lt;9&gt;+<z></z></alt></ctrl></z></alt></ctrl>	<i>z</i> me theks të mprehtë (akut)	serbe lusatiane e poshtme, polake	
Ż	ż	<ctrl>+<alt>+&lt;8&gt;+<z> <ctrl>+<alt>+&lt;8&gt;+<z></z></alt></ctrl></z></alt></ctrl>	z me pikë lart	polake	
0		<ctrl>+<alt>+&lt;5&gt;+<tasti për<br="">hapësirë&gt;</tasti></alt></ctrl>	shenja e shkallës		

# 5.5 Drejtshkrimori

Saktësia e tekstit të vendosur në fushë verifikohet nëse në shfletuesin e internetit keni vendosur mundësinë e verifikimit të drejtshkrimit.

Parametrat në shfletuesin e përzgjedhur të internetit:

• CHROME: Parametrat/Gjuhët/tek Verifikimi i drejtshkrimit\* aktivizoni Verifikimi i drejtshkrimit gjatë vendosjes së tekstit në faqet elektronike apo Settings/Languages/Spell check/Check for spelling errors when you type text on web pages

- EDGE: Parametrat/Gjuhët/ tek Ndihmë gjatë shkrimit aktivizoni Mundëso ndihmën për gramatikën dhe verifiko drejtshkrimin apo Settings/Languages/Writing assistance/Enable grammar and spellcheck assistance
- FIREFOX: *Parametrat/Të përgjithshme/* tek *Gjuha* konfirmoni mundësinë /Kontrollo drejtshkrimin gjatë shkrimit\* apo *Settings/Languages/Check spelling as you type* (që fjalët e shënuara gabim të nënvizohen duhet që në çdo fushë për shënimin e të dhënave të nënfushës së veçantë, nga menuja e shkurtoreve të përzgjidhni mundësinë *Kontrollo drejtshkrimin* apo *Check your spelling*)

225 1 Seria			+	-
a Gabem në titulin e serisë			+	-
v Numërtimi në seri	Zhbëje		+	-
300 Shënimi i përgjithsh	<u>R</u> ibëje		+	-
a Teksti i shënimit	Prije		+	-
320 Shënimi për bibliog	Konioje	jet brenda burimit	+	-
a Teksti i shënimit	7001010		+	-
500 0 0 Titulli uniform	Ngjite		+	-
a Titulli uniform	Eshije		+	-
m Gjuha	Përzgjidh <u>e</u> Krejt	~	+	-
600 1 Emër vetjak si emër	✓ Kontroll <u>D</u> rejtshkrimi		+	-
a Elementi hyrës	Giuhě >	Anglisht (Shtetet e Bashkuara t	ë Ar	merikës)
b Pjesa tjetër e emrit	20010			
f Datat	Inspektojeni	Shqip		
🕱 Përcaktuesi tematik		Shtoni Fjalorë		
w Përcaktuesi i formës				

Kontrollimi i drejtshkrimit në shfletuesin Firefox

# 5.6 Kontrollimi automatik i tekstit

Për paraqitje të saktë të të dhënave në regjistrime, duhet që në shfletuesin e internetit të funksionoj mundësia e kontrollit automatik të tekstit. Kontrollimi automatik (p.sh. nga gjuha angleze ose gjermane në gjuhën sllovene) ndikon në shfaqjen e regjistrimeve.

Parametrat në shfletuesin e përzgjedhur të internetit:

- CHROME: Parametrat/Gjuhët/Përkthyesi Google/Kontrolli automatik i këtyre gjuhëve nuk ka gjuhë të shtuara apo Settings/Languages/Google Translate/Automatically translate these languages No languages added
- FIREFOX: Parametrat/Gjuhët dhe Pamja/Përkthimi/Administroni parametrat e përkthimit të faqeve elektronike dhe gjuhët e instaluara për përkthimin offline apo Settings/Language and Appearance/Translations/Set your language and site translation preferences and manage languages installed for offline translation
- EDGE: Parametrat/Gjuhët/Ofro përkthimin e faqeve, të cilat nuk janë në gjuhët në të cilën lexoni apo Settings/Languages/Offer to translate pages that aren't in a language I read

# 5.7 Veprimet me skedarët

Veprimet me skedarët në aplikacionet COBISS Cat varen nga funksionet e shfletuesit të internetit. P.sh. gjatë eksportit të regjistrimeve, ku gjatë shkarkimit krijohet skedari, me parametrat në shfletuesin e internetit përcaktoni vendndodhjen e ruajtjes dhe emrin e skedarit. Vendi i paracaktuar i ruajtjes së skedarëve më së shpeshti është dosja *Downloads* në diskun lokal (p.sh. C:\Users\[emri i përdoruesit]\Downloads).

Parametrat në shfletuesin e përzgjedhur të internetit:

- CHROME: Parametrat/Shkarkimet/Pyesni se ku duhet të ruani skedarin e veçantë para shkarkimit apo Settings/Downloads/Ask where to save each file before downloading
- FIREFOX: Parametrat/Shkarkimet/Gjithmonë pyesni se ku duhet ta ruani skedarin apo

Settings/Downloads/Always ask where to save files

• EDGE: Parametrat/Shkarkimet/Për çdo shkarkim pyesni se çfarë duhet të bëni me të apo Settings/Downloads/Ask me what to do with each download

Kur të filloj shkarkimi i skedarit, lartë në këndin e djathtë të shiritit të titullit të shfletuesit shfaqet ikona për shkarkim ( <sup>业</sup> ). Kur të përfundoj shkarkimi, klikoni në ikonë dhe përzgjidhni skedarin e duhur.

# 6 Indekset për kërkim

Në këtë kapitull është dhënë shfaqja tabelare e indekseve për kërkim në bazat bibliografike, bazat e njësuara, bazën e të dhënave CORES dhe ISSN. Indekset për kërkim janë klasifikuar në indekse bazë dhe në indekse shtesë. Kërkimi mund të kufizohet përmes prapashtesave të caktuara (p.sh. për llojin e burimit bibliografik, shkrimin etj.).

# 6.1 Bazat bibliografike të të dhënave

# 6.1.1 Indeksi bazë

Me indeksin bazë indeksohen shumica e fushave dhe nënfushave. Tek nënfushat e koduara zakonisht indeksohen edhe shpjegimet nga lista e kodeve.

Në indeksin bazë mund të kërkoni pa shënuar prapashtesat për kërkim. Për nënfushat, të cilat tregojnë më së miri përmbajtjen e dokumentit të indeksuar dhe për këtë arsye përdoren më së shumti për kërkim, ekzistojnë prapashtesat për kërkim. Përmes tyre kërkimin mund ta kufizoni në nënfusha të caktuara.

# 6.1.1.1 Të dhënat bibliografike

PRAPASHTESA	KUPTIMI	KËRKIMI	FUSHAT/NËNFUSHAT
/AB	Përmbledhje ose abstrakt	fjalë	330af
/AU	Autor – person	fjalë	200f, 700abcdf–702abcdf, 900abcdf– 902abcdf, 903abcdf, 904abcdf
/CB	Autor – organizatë	fjalë	710abgh—712abgh, 910abgh— 912abgh, 916abgh
/CL	Seria	fjalë	225adefhiv
/СР	Vendi i mbledhjes/shtojca te emri i institucionit	fjalë	710ce–712ce, 910ce–912ce, 916ce
/GM	Përcaktimi i përgjithshëm i materialit	fjalë	200b, 539b
/NM	Prodhuesi	fjalë	210gh
/NT	Shënime	fjalë	300a, 301a, 311a, 317a, 321ax, 323a– 325a, 328adefg, 338abcdefg
/PM	Vendi i prodhimit	fjalë	210ef
/PP	Vendi i botimit	fjalë	210ab, 620abcd
/PU	Botuesi	fjalë	210c
/PY	Viti i botimit	fjalë	100cd, 210dh
/TI <sup>1</sup>	Titulli	fjalë	200acdehi, 327a, 501ae, 503a, 510aehi, 512ae, 513aehi, 514ae, 515a, 516ae-518ae, 520aehi, 530ab, 531abc, 532a, 540a, 541a, 996h, 997h
/TO	Titulli i origjinalit	fjalë	500ahi

<sup>1</sup> Nëse fraza hyrëse në nënfushën 996h apo 997h është e njëjtë me "ISBN", përmbajtja e nënfushës nuk indeksohet me /TI dhe TI=, mirëpo ISBN që pason këtë varg të shenjave indeksohet me BN=.

# 6.1.1.2 Të dhënat për përmbajtjen (emërtimet lëndore, klasifikimi)

Regjistrimet me emërtimet lëndore SGC mund t'i gjeni edhe nëse gjatë kërkimit përdorni termat e papërzgjedhur nga fushat 4XX dhe 7XX në regjistrimet e njësuara SGC, të cilët nuk ndodhen në regjistrimet bibliografike

PRAPASHTESA	KUPTIMI	KËRKIMI	FUSHA/NËNFUSHA
/CH	Term kronologjik si emërtim lëndor	fjalë	608a, 968a
/CS	Emër organizate si emërtim lëndor	fjalë	601abc, 961abc
/DU	Emërtime lëndore të pakontrolluara	fjalë	610a
/DW	Nënndarje forme	fjalë	600w–609w, 960w–969w
/DX	Nënndarje lëndore	fjalë	600x–609x, 960x–969x
/DY	Nënndarje gjeografike	fjalë	600y–609y, 960y–969y
/DZ	Nënndarje kronologjike	fjalë	600z–609z, 960z–969z
/FN	Emër familje si emërtim lëndor	fjalë	602af, 962af
/FS	Emërtim forme si emërtim lëndor	fjalë	609a, 969a
/GC <sup>2</sup>	Emërtimet lëndore SGC	fjalë	60X (të gjitha nënfushat)
/GE	Fjalë kyçe – NUK	fjalë	627a
/GN	Emër gjeografik si emërtim lëndor	fjalë	607a, 967a
/PN	Emër vetjak si emërtim lëndor	fjalë	600abcdf, 960abcdf
